



Bajrami

DITË GËZIMI DHE UNITETI



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXX i botimit
Nr. 05 (460)
Maj, 2021

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Bajrami, ditë gëzimi dhe uniteti / H. Bujar Spahiu
- 6 Sfida e myslimanit pas Ramazanit / Qani Sulku
- 8 Lajme / Aktivitete



- 12 Shpresa nuk duhet të vdesë (II) / Nuredin Nazarko
- 14 Islami midis mendjes dhe zemrës / Dr. Muhammed Seid Ramadan Buti
- 18 Zekati / Shkëputur nga libri "Ilmihal i zgjeruar", Botim i tre komuniteteve fetare
- 20 Sadakaja e Fitrit / Shkëputur nga libri "Ditët dhe Netët e mira në Islam", Këshilli Botues, KVMSH
- 22 Bajrami dhe simbolika e tij / Ali Zaimi
- 24 Bajrami dhe fëmijët, roli i shkencës në organizimin e atmosferës së Bajramit / Karima Burns



- 26 Termi "Kitab" - Libri / Ali Ynall
- 28 Hafiz Ali Ulqinaku / Faik Luli, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati
- 30 Zgjim' i meritueshëm / Kultura Islame, Viti I, Tetor, 1939
- 32 Si të kontrollojmë zemërimin / Aisa Kokçi
- 34 Zemra nuk ndalet kurrë / Ceyda Sablak
- 38 Shqetësimi i luanit





Bajrami

DITË GËZIMI DHE UNITETI

Ditët e Bajrameve janë gëzimi i individit dhe i shoqërisë, janë ndarja e këtij gëzimi mes njerëzve, janë hyrje në klimën e ndjenjave, janë mundësia që të gjithë myslimanët ta ndjejnë veten vëllezër. Ditët e Bajrameve shëmbëllojnë në ditë paqeje dhe gëzimi, sepse i madh e i vogël kënaqen dhe dëfrehen. Nuk mund të mendohet që të ketë gëzim dhe kënaqësi Bajrami për ata, që u kthejnë shpinën miqve, të afërmeve, fukarenjve dhe vëllait të mbetur mënjane. Në një hadith, Profeti (a.s.) thotë: "Veprimi më i dashur për Zotin pas kryerjes së obligimeve, është kur një mysliman e gëzon vëllain e tij". Porë në këtë drejtim, profeti Muhamed (a.s.) i porosiste shokët e tij që në këto ditë të mos i harrojnë të varfrit dhe nevojtarët. Kështu, myslimanët përpiqen që me veprimtari dhe bamirësi të ndryshme të plotësojnë nevojat e të varfërve dhe jetimëve që edhe ata të gëzojnë.

Bajrami i Ramazanit nis me përfundimin e agjërimit njëmuor dhe vazhdon tri ditë. Ky quhet edhe Fitër Bajrami, meqë gjatë muajit të Ramazanit jepet sadakaja e fitrit si detyrim falënderimi për arritjen e këtij muaji shëndoshë e gëzuar. Myslimanët përjetojnë në këtë festë, gëzimin dhe lumturinë e agjërimit gjatë një muaji me radhë për hir të Allahut, e kapërcimit të vështirësive dhe të çuarjes në vend të urdhrin të Zotit Fuqplotë. Të kremtuarit e këtyre ditëve, na përkujton ditët e lavdishme të së kaluarës së ndritshme Islame dhe i inkurajon myslimanët për angazhime të mëtejshme, për detyra të reja dhe energji më të mëdha në organizimin dhe krijimin e një të ardhme më të mirë e më të lumtur. Jo më kot profeti Muhamed (paqja dhe bekimi i Zotit qoftë mbi të) na thotë se, në Bajrame duhet të tregohet gëzim e hare me qëllim që të manifestohet uniteti, toleranca, forca dhe vëllazërimi.

Në trevat tona shqiptare Bajramet janë festuar gjithmonë solemnisht. Bajrami ka lënë gjurmë të thella e

të pashlyeshme të myslimanët shqiptarë edhe në kohët më të vështira. Ai është freski për familjen, madje, edhe besimtarët më të dobët i kushtojnë Bajramit kujdes e rëndësi të veçantë. Sigurisht, feja islame nuk është vetëm fe e trajtave dhe e ceremonive. Ajo mes trajtave praktike të caktuara, kërkon kuptime të thella e të larta dhe formon një shpirt fisnik. Në këtë mënyrë, Bajrami i jep indikacion të qartë myslimanit se me besim të fortë dhe qëndrueshmëri permanente, mund të arrijë kontroll të përkryer mbi veten dhe të vendosë baraspeshë ideale midis materiale dhe shpirtërore.

Për myslimanët që i besojnë Allahut si një Zot i vetëm dhe që kanë të njëjtin synim e qëllim të përbashkët, grumbullimi në një vend për faljen e Bajramit si një trup i vetëm, ka një kuptim të madh.

Pas namazit të Bajramit, kudo, në qytete e fshatra, në lagje e në rrugë, të njohur dhe të panjohur takohen dhe i urojnë Bajramin me gjithë zemër njëri-tjetrit. Urimi i Bajramit nuk harrohet edhe për ata që janë larg, duke u telefonuar apo duke u dërguar mesazhe urimi. Në këto ditë ndërmjetësohet për të pajtuar të zemëruarit, mëritë dhe armiqësitë marrin fund, miqësitë forcohen, të vegjëlvë u jepen dhurata, vizitohen të sëmurët; sepse kjo është dita e gëzimit dhe e lumturisë së përbashkët. Kremtimi i kësaj feste u jep myslimanëve një emocion të veçantë, një frymë të re, një zell të ri në punët e tyre fetare dhe të kësaj bote. Gjatë kësaj feste myslimanët japin shembullin më të bukur të bashkimit dhe unitetit Islam.

Në fund, lusim Zotin që të jemi pjesë e sihariqit të këtij hadithi të shenjtë, ku Allahu (xh.sh.) përgëzon: "Për Mua agjëruat në muajin e Ramazanit dhe sipas urdhrin Tim falët namazin e Bajramit. Kthehuni tani në shtëpitë tuaja të pastruar nga mëkatet e të falur".



Sfida e myslimanit pas **RAMAZANIT**

Tashmë që muaji i begatë i Ramazanit mbaroi, myslimani përballet me një sfidë të vështirë, e cila është të ruajë të gjithë atë që fitoi gjatë Ramazanit. Atmosfera e Ramazanit është favorizuese për të gjithë ata që synuan t'i afrohen Allahut me adhurime dhe punë të mira. Agjëruan të afërmit dhe të njohurit e tu, agjërove dhe ti; falën taravi të tjerët, iu bashkove dhe ti; shtruan iftare të tjerët, e bërë edhe ti; dhanë sadaka të tjerët dhe ndihmuan të varfërit, edhe ti me aq mundësi sa pate, nuk u kurseve në këtë anë. Në fund të Ramazanit, jam i sigurt që u ndjeve më besimtar dhe më i devotshëm sesa para fillimit të agjërit. Nëse vërtetë ndihesh kështu, ti ke bërë një arritje shumë të madhe; ke korrur një fitore ndaj vetes tënde, duke e kalitur atë, me qëllimin e vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. Me këtë që bërë, ti i ngjan një artizanati, që me duart e tij realizoi një veshje shumë të bukur për veten, por tashmë ka ardhur koha që atë ta mbaj veshur deri për Ramazanin e ardhshëm. Ashtu edhe ti, unë dhe çdokush tjetër që u përpoq gjatë Ramazanit me agjërim, lexim Kurani, falje namazi, sadaka, etj, të përpiqemi që çfarë bëmë në Ramazan, të mos mbetet vetëm në Ramazan, por edhe

në vazhdimësi, pasi Zoti ynë, është po Zoti ynë edhe pas Ramazanit. Falenderimet dhe madhërimet tona ndaj Tij duhet të jenë të vazhdueshme, pa ndërprerje, edhe pse jo me të njëjtin intensitet si në Ramazan. Përndryshe do t'i përngjajmë asaj plakës që tjerri një triko leshi gjatë gjithë natës dhe sapo e përfundoi, e prishi trikon, pa e veshur fare, apo si shembulli i lopes, e cila e mbush me qumësht kovën plot, dhe pastaj i fut shqelmin dhe e derdh atë. Ashtu edhe ne, nëse do mjaftohemi vetëm me agjërimin e Ramazanit; vetëm me faljen e taravive dhe me përkujtimin e Allahut vetëm një muaj në vit.

Ne ndoshta nuk kemi mundësi të agjërojmë çdo ditë pas Ramazanit, por përderisa mundëm ta agjërojmë të plotë muajin e Ramazanit, a nuk kemi mundësi të agjërojmë 1 apo 2 ditë në javë, apo më e pakta fare, 1 ditë muaj. Ne që lexuam të gjithë Kurandin gjatë Ramazanit, ku i bie të kemi lexuar 20 faqe në ditë, pasi i gjithë Kurani ka 600 faqe dhe e kemi mbaruar për 30 ditë, a nuk kemi mundësi, që jashtë këtij muajit të bekuar të lexojmë nga 2 faqe në ditë, kështu ne, në fund të çdo muaji do kemi lexuar 60 faqe, dhe ende pa mbërritur Ramazani i ardhshëm, do e kemi lexuar të plotë të gjithë librin e



Allahut. Ne patëm vullnetin e hekurt gjatë Ramazanit t'i falnim taravitë 8 apo 20 rekate, përveç namazeve farze (obligative), dhe këtë e bëmë pa pushim përgjatë 30 ditëve të këtij muaji. A nuk e kemi mundësinë që jashtë Ramazanit, bashkë me namazet farze t'i falim edhe sunetet?

Gjatë Ramazanit nuk prituam asnjë natë që të zgjohemi në pjesën e fundit të saj, për të ngrënë syfyr dhe prisnim derisa vinte koha e namazit të sabahut dhe e falnim atë. Namazi i sabahut, është një namaz që vazhdon edhe pas muajit të Ramazanit, kështuqë duhet të mundohemi që ta falim në kohë, edhe gjatë muajve të tjerë. Le t'i përgjigjemi vargut të ezanit që thotë: "Namazi është më i mirë se gjumi". Edhe pse me më pak orë gjumë në Ramazan, nuk na gjeti gjë. Ja ku jemi prapë, pasi ai nuk vjen për ta dëmtuar njeriun, përkundrazi për të qenë në dobi të tij. Ramazani erdhi për të na disiplinuar dhe për të na nxitur drejt mirësive. Në Ramazan, e gjtëm mundësinë për të agjëruar; e gjetëm kohën për të lexuar Kuran, për të falur namaz, për të shtruar iftare; e patëm mundësinë për të dhënë sadaka dhe për t'i qëndruar pranë shtresës në nevojë. Këto "kohë" dhe "mundësi" ne mund t'i posedojmë

edhe në muajt e tjerë. Mjafton t'ia vëmë qëllim vetes dhe të bëjmë çfarë kemi në dorën tonë për ta realizuar dhe kemi për ta parë që edhe Allahu ka për të na e lehtësuar kryerjen e çdo adhurimi dhe veprë të mirë. Allahu, që na e lehtësoi agjërimin e Ramazanit, duke e freskuar kohën, saqë asnjë nuk ndjeu as etje as uri, ka mundësi të na lehtësojë agjërimin edhe në ditë të nxehta të Korrikut apo të Gushtit; ka mundësi të na e lehtësojë kryerjen e adhurimeve ditën dhe natën; ka mundësi të na shtojë rizkun dhe të ardhurat tona, në mënyrë që prej tyre të japim lëmoshë dhe të mbështesim nevojtarët. Nuk na ka hije të fshihemi pas arsyetimeve dhe justifikimeve të pabaza.

Nuk po them që është e lehtë, por gjithashtu nuk them që është e pamundur. Sfida është më e madhe tani, pasi jemi në një luftë të pandashme me shejtanin dhe me të keqen që vepron brenda nesh. Mjafton të mos i bindemi cytjeve dhe urdhrave të tyre; mjafton të mos biem peng i prangave të tyre. Allahu na e lehtësoftë të gjithëve të ruajmë me fanatizëm dhe me vendosmëri gjithçka që arritëm me mund, mish dhe me shpirt përgjatë ditëve dhe netëve ndriçuese të muajit të madhërishtëm të Ramazanit!



1

FUSHATË BAMIRËSIE - KMSH, I VJEN NË NDIHMË MBI 6000 FAMILJEVE NË NEVOJË

Në prag të Muajit të Bekuar të Ramazanit, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë në bashkëpunim me Qendrën Bamirëse dhe Humanitare "Mbreti Selman" dhe Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë, hapën fushatën e bamirësisë në ndihmë të mbi 6000 familjeve me vështirësi ekonomike në mbarë vendin tonë.

Ceremonia e lançimit të kësaj nisme u organizua më 8 prill, ora 10:30 në ambientet e Medresesë së Tiranës.

Të pranishëm ishin Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, z. Abdelmomen Mohammed Sharaf dhe përfaqësues të Qendrës Humanitare "Mbreti Selman".

Fushata konsiston në shpërndarjen e pakove me ndihma të ndryshme ushqimore. Fillimisht pakot me nga 70 kg ushqime secila (600 ton), do t'ju dorëzohen përfaqësuesve të KMSH-së në çdo qytet të vendit, më pas këta të fundit do t'jua shpërndajnë familjeve në nevojë.

Në si besimtarë e dimë shembullim e bukur, shembullin e dhënies për nevojtarin, profeti ynë, Muhamedi (a.s.) ka ndarë edhe një hurmë në disa pjesë me njerëzit përreth tij.

Gjithashtu na është bërë e ditur se nuk mund të bëjë gjumë të rehatshëm një besimtar i devotshëm ndërkohë që fqinji i tij nuk vë gjumë në sy nga uria.

Ambasadori i Arabisë shprehu falënderimet e tij për këtë bashkëpunim të frytshëm me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe theksoi prestigjin e lartë të besueshmërisë që ky institucion gëzon.





2

NËNSHKRIMI I KONTRATËS SË BASHKËPUNIMIT PËR RINDËRTIM

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë nënshkruan kontratën e bashkëpunimit për rindërtim me Bashkësitë Islame të Diasporës. Kontrata është nënshkruar mes;

-H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë,
-Z. Mehas ALIJA, Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër (KMSHZ)/Dachverband der Albanisch-Islamischen Gemeinschaften in der Schweiz (DAIGS).

-Z. Vahidin BELULI, Kryetar i Bashkësisë Islame të Austrisë (KSHBIA)/ Albanische Kultusgemeinde der IGGO (ALKIG).

-Z. Reshat IBISHI, Kryetar i Bashkësisë Fetare Islame të Italisë (BFII) / Comunità Religiosa Islamica D'Italia (CRII).

Kontrata ka për qëllimin bashkimin e fondeve dhe të konkretizimit të detyrave dhe përgjegjësi të palëve sa i përket ndërtimit/ rindërtimit dhe/ose rikonstruksionit të objekteve të dëmtuara si pasojë e tërmetit të vitit 2019 që goditi Shqipërinë...

Zoti i shpërbleftë bashkatdhetarët tanë të Diasporës!





3

OLIMPIADA E TALENTEVE NË MEDRESE

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Drejtoria e Arsimit, organizoi olimpiadën e talenteve në medrese, e cila përfshiu të gjitha medresetë e Shqipërisë.

Olimpiada u organizua në distancë dhe u shtrirë në kohë, nisur nga situata e pandemisë.

Ajo filloi në muajin shkurt dhe u finalizua me ceremoninë e ndarjes së çmimeve më datë 15 prill 2021, ku ishin të pranishëm Kryetari i KMSH H. Bujar Spahiu, Nën/kryetari Taulant Bica, Drejtori i Arsimit Agron Hoxha (organizatori), Drejtori Çështjeve Sociale Edvin Kuçi, drejtuesit e jurive respektive, përfaqësuesit e medreseve dhe nxënësit fitues.

110 nxënës të medreseve të Shqipërisë shpalosën talentet e tyre sipas tri kategorive të konkurimit të olimpiadës.

Olimpiada, e cila synon nxitjen e zhvillimit dhe promovimit të aftësive dhe talenteve individuale të nxënësve të medreseve u organizua në kategoritë e leximit të Kuranit, esesë dhe interpretimit.

Përzgjedhja e fituesve u bë nga një juri e pavarur ekspertësh të secilës fushë të konkurimit.

Në fund u ndanë nga tre çmime, ku fituesit e çmimeve të parë morën nga një Laptop, çmimet e dyta nga një tablet dhe çmimet e treta nga një smartfon.

4

KONFERENCA ONLINE E ORGANIZUAR NGA KËSHILLI BOTËROR I KOMUNITETEVE MYSLIMANE

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, mori pjesë, me ftesë të posaçme, në konferencën online të organizuar nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane, me qendër në Abu Dabi.

Konferenca u zhvillua në kuadër të Muajit Bekuar të Ramazanit.

Temë e kësaj konference ishte; "Myslimanët në Europën Juglindore - historia, tradita, kultura...".

Gjatë fjalës së tij, Kryetari Spahiu referoi rreth "Historisë së Islamit në Shqipëri, kulturës dhe atdhetdashurisë".

Myslimanët e shqiptarë kanë qenë gjithmonë krenarë për përkatësinë e tyre nacionale dhe atë fetare.

Prezenca e islamit në Shqipëri daton shekuj më parë, pavarësisht sfidave, ne, si Komunitet Mysliman i Shqipërisë, punojmë fort që t'i pajisim brezat me dije e besim për t'i shërbyer fesë dhe kombit, e t'i mbrujtim ata me shpirtin e bashkëjetesës dhe dialogut njerëzor e kulturor.

Ishin këto disa nga pikat ku mbështetej referimi i Kryetarit Spahiu në këtë konferencë.





5

TAKIM ME MYFTINJTË

Në kuadër të fillimit të muajit të bekuar të Ramazanit, drejtuesit më të lartë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në datat 6-7 prill 2021, zhvilluan takime pune me të gjithë myftinjtë e Shqipërisë.

Mbarëvajtja dhe koordinimi i aktiviteteve përgjatë muajit të Ramazanit, çështja e organizimit dhe shumë të tjera ishin qëllimi i këtyre takimeve.

-Ramazani është muaji më i rëndësishëm për ne dhe çdo besimtar, të mundohemi ta përjetojmë ashtu siç i ka hije këtij muaji të madh, me adhurime, lutje, ndihmë për të pamundurët e nevojtarët, si dhe të jemi afër çdo besimtari, tha Kryetari Spahiu ndër të tjera në fjalën e tij me myftinjtë.





Shpresa **NUK DUHET TË VDESE (II)**

Frikë nga zullumi. Zullumi shtohet në një shoqëri, kur njerëzit i largohen gjithmonë e shumë drejtësisë, por jo drejtësisë që bazohet në tekat e njerit apo tjetrit që formulon ligje e rregulla. Kur i largohen drejtësisë që ndërtohet mbi bazën e moralit. Drejtësi pa moral nuk mund të ketë. Virtyte pa moral nuk mund të ketë. Kush nuk ka virtyte nuk mund të marrë vendime që bazohen mbi drejtësi. Njeriu pa virtyte është i mbytur nga vetvetja. Në këtë gjendje zullumi dhe trashja e tij janë realitete të pashmangshme. Fjala dhe veprimi me padrejtësi rrit frikën dhe shqetësimin tek ai që flet e vepron dhe tek ai mbi të cilin bie fjala e veprimi. I pari frikësohet se mos ndoshta vjen një ditë që zullumi t'i kthehet kundër dhe të mos ketë asgjë që ta shpëtojë nga zemërimi i atyre që u ka shkaktuar padrejtësi. I dyti frikësohet sepse mendon që është i pafuqishëm për t'iu kundërvënë fuqisë së zullumit. Një kundërvënie dhe kalvari i vuajtjeve deri në vdekje mund të trokasë sakaq pas dere. Njeriu jeton me frikën e ndëshkimit nga pushteti zullumqar, por dhe pushteti zullumqar jeton me frikën e rebelimit të njerëzve. Për shkak të kësaj frike pushteti zullumqar rrit shtypjen dhe terrorin ndaj njerëzve. Ndërsa njerëzit që jetojnë në periudhën e këtij pushteti rritin heshtjen dhe durimin ndaj shtypjes, në pritje të daljes së dikujt që do të shërbejë si shkëmbijë e zjarrit që do të asgjësojë zullumin. Frika nga zullumi mund të shkaktojë mpirje të përkohshme nervash, topitje të zemrave, por është e përkohëshme. Njeriu duhet të edukohet për të dashuruar lirinë më shumë sesa jetën pa liri. Vetëm kështu shpirti i rezistencës nuk shuhet. Vetëm kështu mund të ndizet zjarri i lirisë që djeg dhe asgjëson zullumin.

Frikë nga vetvetja. Njeriu që njeh virtytet si kufiri fundmë ku duhet të përfundojë, i frikësohet më shumë vetvetes. Ai njeh dobësitë. Di se në cilat pika mund të thyhen portat e kështjellës së tij. Nuk frikësohet nga sulmet, sepse së jashtmi janë porta të koracuara. Frikësohet nga dobësia e tyre e brendshme dhe dijenia se gërryerja nga brenda mund të sjellë shembjen e këtyre portave. Frika e humbjes së virtyteve e çon drejt përpjekjeve për t'i ruajtur ato, jo duke i ikur shoqërisë, jo duke i ikur problemeve, sfidave, por duke qëndruar përballë tyre me besim dhe kurajo. Duke u përkujdesur që të kurojë plagët që lindin në këtë betejë me vetveten në mesin e të tjerëve, për të përçuar një shembull se si njeriu duhet të ruajë qenien e tij. Të kesh frikë nga vetja nuk do të thotë se je frikacak. Edhe më trimi në fushën e betejës i frikësohet vetvetes më shumë sesa kundërshtarit që qëndron përballë. I frikësohet tradhëtisë së vetes ndaj virtyteve. Kjo

është frikë e domosdoshme. Pa këtë frikë njeriu nuk do të tregonte kujdes për të ruajtur kështjellën e vet nga goditjet që do të rrëzonin jo vetëm portat, por dhe muret. Kjo frikë nuk duhet humbur. Nuk duhet asgjësuar. Përtej përgjumjes që mund të ndodhë, rigjallërimi i vazhdueshëm i saj mbetet detyrë e njeriut për të shpëtuar veten nga dobësitë e vetvetes.

Frikë nga antikonformizmi. Njeriu është qenie shoqërore. Kemi edhe raste të njerëzve që zgjedhin të jetojnë të shkëputur nga shoqëria për të mos u molepsur me vorbullën e sfidave që mund të rrezikojnë pastërtinë e qenies. Se sa ia arrijnë t'ia dalin në këtë pjesë kjo është tjetër histori. Të zgjedhësh të qëndrosh në mesin e shoqërisë, të sfidosh veten me vorbullat që mbështillen e çmbështillen përqark saj është sfidë që jo çdokush mund ta durojë. Për rrjedhojë njerëzit një e nga një i bashkëngjiten masës, duke marrë ngjyrën, formën dhe përmbajtjen e saj. Njëtrajtësimi më shumicën zhbën forcën e stigmatizimit, paragjykimin dhe stereotipizimit. Kësisoj nuk duhet të durosh gjuhustrat. Por sa e vlefshme është kjo gjendje?

Të jesh antikonformist nuk nënkupton thjesht kundërvënie ndaj shumicës me detaje të cilat për shumicën nuk përbëjnë aspak shqetësim. Antikonformizmi ka të bëjë me zgjedhjen e një mënyre të jetuari ndryshe nga sa ka zgjedhur shumica, mënyrë e të jetuari që ndërtohet mbi parimet e epërme. Duke zgjedhur këtë mënyrë të jetuari shigjetimi nuk do të vonojë. Kjo është natyra njerëzore. Kundërvënie ndaj asaj që mendjes së kufizuar njerëzore nuk i duket logjike. Për konformistët është alogjike të zgjedhësh ecjen në kundërrjedhë. Është alogjike të kesh qypin e mjalitit para dhe të mos marrësh lugën apo garuzhden për të ngrënë. Për antikonformistin refuzimi i mjalitit edhe kur ke qypin para është një akt i lartë i mposhtjes së lëndores nga shpirtërorja, për aq sa marrja e mjalitit është e padrejtë dhe në kundërshtim flagrant me parimet e epërme. Refuzimi është çasti i çlirimit nga frika prej antikonformizmit. Kjo është gjendja në të cilën duhet synuar dhe duhet punuar për ta arritur. Përnjështim me parimet e epërme dhe ecje krenar në jetë, por jo ecje me krenari përçmuese. Ecje me krenari që të mbush zemrën me dashuri për të gjithë njerëzit, duke treguar vlerën e madhe që kanë parimet e epërme në jetën e njeriut. Ecje me krenari duke urryer të keqen dhe duke dashur të mirën për të gjithë njerëzimin.

Përballë shpërhapjes së të keqes dhe ulërimit të saj shurdhuese, shpresa e përnjështimit me parimet e epërme për të gjetur bukurinë e jetës edhe në terrin dhe vështirësitë më të mëdha nuk duhet shuar kurrësi. Kjo është shenja dalluese për zemrat që kuptojnë.

ISLAMI

mes mendjes dhe zemrës

Allahu xh.sh e krijoi njeriun dhe e pajisi me dy të vërteta të mëdha, të cilat janë: Mendja dhe zemra. Ai i dha secilës prej atyre të dyjave nga një detyrë të cilën nuk do të mund ta kryente asgjë tjetër përveç tyre dhe nuk do të vlente asgjë pa verifikimin dhe konfirmimin e tyre prej çështjeve të dynjasë dhe të Ahiretit.

Për sa ka të bëjë me mendjen, detyra e saj është që ajo t'u afrohet gjërave, të perceptojë realitetin e tyre, të deduktojë prej dukurive të jashtme të gjërave atë çfarë gjendet prapa tyre dhe, prej kësaj, të arrijë te njohja e Allahut, te besimi në Njësimin e Tij dhe në Zotërimin e Tij Absolut.

Ndërsa lidhur me zemrën, detyra e saj është që ajo të ecë pas udhëzimit të mendjes, ta dojë atë të mirë, të cilën mendja e vërteton se është e mirë, dhe ta urrejë të keqen, të cilën mendja e vërteton se është e keqe, duke e ndërtuar skemën e të gjithë asaj në rrugën e kënaqësisë së Allahut.

Sigurisht, për ndërtimin e botës dhe për vendosjen e rregullit në të kërkohet vënia në funksion e këtyre dy aparateve. Në qoftë se nuk do të ishte mendja, do të përzihehin tekat dhe fantazitë e nefsit me rrahjet dhe ndjenjat e zemrës, dhe do të bëheshin bashkë e ulëta me të lartën për ndezjen e një të keqeje ndjellazezë, e cila do të prishte çdo gjë, "Sikur e Vërteta të ishte sipas dëshirave të tyre, atëherë do të shkatërroheshin qiejt dhe toka dhe gjithçka që gjendet në to..." (El-Mu'minun, 23:71).

Po të mos ishte zemra, nuk do të gjendej e mira veçse në botën e iluzionit dhe të fantazisë. Atëherë, do të mbetej struktura e virtuteve dhe e idealeve më të larta thjesht dhe vetëm në plane e projekte në letër, ose thjesht fjalë e fjali në

gojë. Kështu mendja është fuqia zbuluese dhe planifikuese, kurse zemra është fuqia shtytëse dhe lëvizëse.

Në çdo punë ose ndërtim kërkohet, së pari, të bëhet projekti i saktë dhe i mirë-sistemuar; pastaj, së dyti, kërkohet mjete zbatues i tij. Duke parë se Islami është përfshirësi i të gjitha vlerave, atëherë kërkohet medoemos, për realizimin e kësaj detyre, mbështetja te këto dy aparate të mëdha. Për këtë arsye erdhi Islami që t'u drejtohet njëherazi mendjes dhe zemrës. Ai i drejtohet mendjes me qëllim që ajo të perceptojë e të planifikojë; dhe i drejtohet zemrës me qëllim që ajo të dojë dhe të ndikohet. Sigurisht, ti do të gjeje shumë ajete të Librit të Qartë që u drejtohen lidhjeve të zemrës pikërisht në kohën që ato ajete komunikohen për të zgjuar perceptimet e mendjes. Kjo është me qëllim që secili të ngrihet për të kryer funksionin e tij dhe të kontribuojë në realizimin e humanizmit të njeriut; dhe pastaj ta ngrejë atë te niveli i adhureshmërisë së tij ndaj Allahut. Gjithashtu ti do të gjeje Hadithe të Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, në të cilët Profeti Muhamed gjithmonë e refuzonte në qoftë se besimi me mendje nuk do të shoqërohej me dashurinë e zemrës. A nuk e ke dëgjuar Pejgamberin të thotë në hadithin e saktë: "Askush prej jush nuk beson derisa unë të jem më i dashur për të se sa pasuria e tij, fëmija e tij dhe se sa të gjithë njerëzit". Gjithashtu në një hadith tjetër të saktë ai tha: "Tek ai që ndodhen tri gjëra, ai do të gjejë ëmbëlsinë e besimit: Që Allahu dhe Pejgamberi i Tij të jenë më të dashur për të se sa çdo gjë tjetër; që njeriu të dojë veçse për hir të Allahut; dhe ta urrejë kthimin në mohim, ashtu siç urren që ai të flaket në zjarr".

E VËRTETA E BESIMIT

Pastaj ti, gjithashtu, do ta gjeje të mishëruar këtë kuptim në atë për të cilën kanë konsensus unanimitisht shumica e dijetarëve të Islamit, se 'Besimi shtohet dhe pakësohet' dhe se myslimanit i kërkohet të punojë për ta forcuar e shtuar besimin e tij. Është e vetëkuptueshme se fusha e këtij shtimi nuk mund të jetë mendja, sepse mendja nëse përparon në perceptimin e diçkaje deri në shkallën e besimit dhe të nënshtrimit, ajo sigurisht që ka arritur te fundi i skajshëm, përtej të cilit nuk mund të kalohet; meqë perceptimi për diçka është thjesht edhe vetëm përfytyrim edhe konceptim edhe vërtetim. Vërtetimi është përfundimi më i lartë logjik, i cili nuk pranon kundërshti e dyshim. Atëherë, sigurisht vërtetimi me mendje nuk pranon asnjë shtim apo pakësim; por fusha e këtij shtimi nuk është veçse zemra. Në zemër ndodhet një shkallë ndjenjash, shkelëzat e së cilës pothuajse kurrë nuk mbarojnë. Në të ndodhet një lëndë e madhe djegëse prej pasionesh të mëdha e të fuqishme, të cilën nuk mund ta përshkruajë asnjë laps apo diksion. Në këtë poçe -enë-piqet dhe lulëzon besimi. Në të riprodhohen mrekullitë e besimit, për të cilat kemi dëgjuar shumë shpesh në të shkuarën, por që jeta jonë mbeti shterpë në të tashmen. Shikoje Deklaratën Hyjnore se si e përshkruan këtë fushë të zemrës për të forcuar e shtuar besimin dhe medito rreth Fjalës së Tij: "Dhe dijeni mirë se mes jush është i Dërguari i Allahut. Po të ishte se ai do t'ju bindej juve (duke ndjekur dëshirat e mendimet tuaja) në shumë çështje, ju sigurisht që do të ishit në telash, por Allahu e ka futur thellë besimin tek ju dhe jua ka zbukuruar atë në zemrat tuaja, ndërsa jua ka bërë juve mosbesimin, poshtërsinë dhe mosbindjen (ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij) të urryer për ju. Pikërisht këta janë ata të udhëzuarit drejt". (El-Huxhurat, 49:7). Dhe ti je i mirinformuar se dy fjalët, "Habbebe" (Ai jua bëri të dashur), dhe "Zejjene" (Ai jua ka zbukuruar), të dyja këto fjalë i njeh fjalori i zemrave; ato vijnë pas mendjes dhe nënshtrimit të saj.

E VËRTETA E DASHURISË

Pastaj, kjo dashuri, në kuptimin e saj të vërtetë, nuk është thjesht ndjekja dhe sjellja praktike, siç mund ta përfytyrojnë disa njerëz, por ajo është përdorur pikërisht në kuptimin e saj të mirëfilltë. Kështu, ndjekja nuk është veçse një ndikim prej ndikimeve të saja. Atëherë, si do të ishte dashuria ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij një ndjekje praktike?! Vetë ndjekja, për sigurinë e mendjes, ka nevojë për një dashuri shtytëse të zemrës. Natyrisht, kuptohet me intuitë se akti prej sakrificave të mëdha dhe të ndritshme, që e paraqitën Sahabët me veten dhe pasurinë e tyre, nuk ishte vetë dashuria, por ishte një ndikim prej ndikimeve të dashurisë së madhe, të cilën zemrat e tyre e bënë të vërsjojë. Përndryshe ajo do të ishte thjesht vërtetim i asaj që është vetë misteri i sakrificës në rrugën e saj. Atëherë, do të bëhej detyrim me mendje që të barazoheshin të gjithë myslimanët

në cilësinë e bërjes së sakrificës dhe vetëfljimit. Kush do të mund ta thoshte këtë? Dhe kush ka pretenduar se vetë çështjet mendore kanë ndikim në mendje e në zemra? A ka dëgjuar ndonjëri prej njerëzve që një njeri ta ketë sakrifikuar jetën e tij për shkak se ka besuar në ndonjë rregull matematikor apo në ndonjë problem prej problemeve të algjebërës?

VIRTYTI DHE LIGËSIA

Sa të drejtë kishte "Zhan Zhak Ruso - Jean-Jacques Rousseau" në atë ditë që nisi të përqueshte ata që mendonin se thjesht besimi në virtytin konsiderohet fitore për të dhe për përmbushjen e parimeve të tij. Ai thotë: "Sa shumë është thënë e rithënë rreth dëshirës për ta vendosur virtytin te thjesht mendja! Oh sa bazament i fortë! Çfarë bazamenti është ky?! Virtyti, ashtu siç thonë, është sistemi. Por a është e mundur që besimi në sistemin ta kapërcejë ëndjen time të veçantë? Ky parim i pretenduar nuk është gjë tjetër veçse lojë fjalësh. Ligësia është dashuria për sistemin në një formë të ndryshme".

Shiko! Një ditë Amerika perceptoi se në alkool ndodhen dëme e pasoja të rënda të ndryshme; dhe ajo e besoi këtë me mendje, duke u mbështetur në prova të sigurta dhe në tregues të ndryshëm eksperimentalë dhe shkencorë. Në bazë të kësaj, qeveria amerikane mori guximin që të shpallte me ligj ndalimin e alkoolit. Por çfarë ndodhi pas kësaj? Sapo kaloi një periudhë e shkurtër kohe, filluan t'u merreshin mendtë kokave të vetë atyre kodifikuesve të legjisllacionit prej dhimbjes së privimit. Pastaj ata u tërhoqën dhe e grisën projektligjin, që gati do ta miratonin e shpallnin. Kështu, ata nisën përsëri të merreshin me gotat e mbushura me alkool.

Kurse në Medinën e Ndriçuar, para katërmëdhjetë shekujve, një grup prej analfabetësh, jeta e të cilëve qysh prej një kohe të gjatë ishte ndërtuar me alkoolin, duke e konsideruar atë aq të domosdoshëm si domosdoshmërinë e diellit, të ajrit dhe të ujit dhe të cilët e konsumonin shumë alkoolin, tek ata ndodhi mrekullia nëpërmjet misterit të një ajeti të vetëm, i cili përmban vetëm pak fjalë. Ata sapo e dëgjuan Fjalën e Allahut të tyre në fund të ajetit, "... Kështu, a nuk do të hiqni dorë, pra? (El-Maideh, 5:91), ata menjëherë e derdhën alkoolin, thyen gotat e alkoolit dhe shprehën me klithma: "Ne hoqëm dorë, o Zoti ynë". Vetëm për një orë kohë alkooli, prej një elementi prej elementeve të jetës - i cili konsiderohej i domosdoshëm si domosdoshmëria e diellit, e ujit dhe e ajrit - u transformua në një fëlliqësi e ndyrësi të keqe. Në një orë të vetme u shfuqizua një zakoni i fortë e i vjetër, sikur ai zakoni të mos ishte dje dhe sikur ai të mos kishte rrënjë të thella e të largëta. Atëherë cili është ndryshimi mes Amerikës, që besoi në eksperimentin, njohjen dhe shkencën dhe mes Sahabëve të Pejgamberit të Allahut, të cilët e pritën çështjen me pranim dhe e besuan atë nga e Padukshmja?

Ndodhet një siguri e paarmatosur, të cilën nuk e arrin nefsi dhe nuk e mbështet epshi; dhe ndodhet diçka e

cila vendoset në zemër dhe qëndron në mendim. Zemra është prijësi i të gjithë kësaj qenieje njerëzore, duke e drejtuar atë si të dojë dhe duke e çuar në rrugën që ajo dëshiron. Pastaj zemra është si pasqyra, e cila nuk mund të zhvishet e nuk mund të jetë pa format që shfaqen në fytyrën e saj. Në të, ose do të vërtetohen forma të turbullta prej dynjasë dhe prej fantazive të saj, ose ajo do të shkëlqejë me Dashuri të Vërtetë Hyjnore. Në qoftë se zemra do të vërshonte me turbullirat e epsheve dhe të fantazive, atëherë sa e pamundur dhe sa larg do të ishte që vetë besimi të bëhej nxitës i njeriut për çfarëdo akti prej akteve të sakrificës apo të vetëfljimit?!

DASHURIA HYJNORE

Cila është rruga për pastrimin e zemrës dhe për mbjelljen e Dashurisë Hyjnore në të derisa të shtohet besimi nëpërmjet saj dhe që të shumohen faktorët bazë të vetëfljimit, dhënies dhe të xhihadit?

Përgjigjja: Ti ke rrugë të shumta për këtë. Prej më të rëndësishmeve të këtyre rrugëve është ajo që ti të veçohesh me veten tënde midis çdo periudhe kohe dhe çdo etape. Medito në të për nefsën tënd, për të vërtetën dhe origjinën e tij dhe sa shumë i nevojshëm është ai për përkujdesjen e Allahut dhe për suksesin nga ana e Tij në çdo çast të jetës. Medito rreth mirësive të shumta të ndryshme me të cilat Allahu të nderon ty në gjendjet, rrethanat dhe në transformimet e tua. Pastaj medito rreth njerëzve dhe pafuqisë së tyre të skajshme para Krijuesit dhe rreth mospasjes së asnjë dobie prapa lavdërimit të tyre, ose shpifjes së tyre, ose mbështetjes tek ata. Pastaj mendo se sa e lartësuar është Madhështia e Krijuesit në shfaqjet e mirësive të Tij të ndryshme dhe të përkujdesjes së Tij, të cilat nuk mund të numërohen. Mendo se si Ai të ka dhuruar ty mantelin e mbulimit dhe të fshehjes së Tij, dhe si i ka penguar njerëzit duke i mbajtur larg të metave të tua dhe duke i mbajtur ato të meta sekret midis Tij dhe teje. Pastaj Ai i përhap tek ata virtytet e tua dhe aktet e tua të lavdërueshme, kur ti vetë nuk e synove atë gjë. Pastaj ndiqe këtë me shumimin e Dhikrit- Përmendjes- së Tij duke bërë Tesbihate -Lëvdata- me zemër e me gjuhë dhe duke shpeshtuar recitimin e Kur'anit.

Gjithashtu, midis më të rëndësishmeve të këtyre rrugëve është ajo e shqyrtimit të shumë lidhur me Biografinë e Profetit Muhamed, me moralin e tij, me mënyrën e tij të jetuarit dhe të trajtimit të njerëzve nga ana e tij, sepse e gjitha kjo është pjesë prej shfaqjes së Profetësisë së tij. Është veçori e këtij shqyrtimi që ta forcojë besimin dhe ta ngulisë atë në zemër. Pastaj zemra, në këtë gjendje, dridhet e vlon me dashurinë e virtyteve dhe me idealet më të larta. Çfarëdo që të studioje e kërkoje, ti nuk do t'i gjeje virtytin, shembullin më të lartë dhe aspektet e mirësjelljes dhe të bukurisë personale e morale të grumbulluara në ndonjë qenie të vetme, veçse në qenien e më të mirit të krijesave, në qenien e Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. Atëherë s'është për t'u

habitur që ai të jetë boshti i zemrave të medituesve dhe të shqyrtuesve si dhe modeli i të gjithë mendimtarëve të drejtë.

Gjithashtu, midis më të rëndësishmeve të rrugëve është ajo e shtimit të akteve të përgjithshme të adhurimit dhe të salavateve të veçanta, duke qëndruar drejt tek ato me devocion, frikë dhe duke ndierë Praninë Hyjnore. Dhe betohem për Zotin! Nuk do të binin pasojat e ndryshme që lidhen me nefsën dhe as nuk do të gjallërohej zemra me dritën e dashurisë dhe të njohjes, veçse pasi të shtohen e shumohen adhurimi dhe virgjëria -pastërtia morale- në jetën e myslimanit derisa të shtrihet ndikimi i tyre në nefs dhe në zemër dhe t'i tundin ato të dyja duke i nxitur, nëpërmjet uljes dhe ngritjes, mes dy anëve të frikës dhe të shpresës. Dhe pikërisht kështu bien pasojat e lidhura me nefsën dhe do të hiqej ai perikard -cipë- e turbullt e shtrirë në faqen e zemrës.

Në qoftë se myslimani do të ecte në këtë rrugë dhe nëse do të përgatitej për të ndërmarrë këtë detyrë, atëherë, nga kjo do të mbinte në zemrën e tij një dashuri e madhe hyjnore, duke e bërë atë që të mos frikësohej prej asnjë të madhi tjetër, që të përçmonte çfarëdo lloji tundimi prej gjërave tunduese, të shpërfillte çdo lëndim e ndëshkim dhe të ngjitej lart mbi çdo poshtërim apo qesëndi. Betohem se ajo është pajisja më e madhe me të cilën Allahu e pajisi të dashurin e Tij, Muhamedin, për të marrë përsipër peshat e thirrjes islame. Ajo është pajisja me të cilën duhet të armatohet, pas tij, çdo mysliman.

Dëshiroj ta vendos dorën tënde, pas kësaj që përmenda, te pusia e sëmundjes kronike në jetën tonë islame sot.

SËMUNDJA KRONIKE

Sëmundja jonë e rëndë kronike është se ne myslimanët, me mendim dhe mendje dhe jo me dashuri e me zemër, domethënë, është se ne ushtrojmë thjesht një Islam me mendje larg tërheqjeve të zemrës dhe ndikimeve të saja. Një lloj i këtillë prej jetës islame mund të prodhojë pasuri të madhe ideologjike ose një bibliotekë të gjerë Islame, por ai lloj nuk do ta prodhonte kurrë lumturinë e synuar islame. Mishërimi më i vogël i kësaj të vërtete, të cilën po e shpreh, është, për shembull, se ti mund të takohesh me një grup ose xhemat prej myslimanëve të cilët kanë qendrën kryesore të mendimit dhe të udhëheqjes islame në vendin ku ata gjenden. Midis tyre fillon diskutimi rreth Islamit, rreth mënyrës së thirrjes për tek ai, për t'u lartësuar nëpërmjet tij dhe rreth detyrës së myslimanëve në këtë shekull. Ata zhyten në këtë diskutim me energji, kënaqësi dhe entuziazëm. Në afërsi të tyre dëgjohet zëri i lartë i myezinit, duke thirrur ezanin për faljen e namazit. Por diskutimi vazhdon. Thirrja e ezanit mbaron dhe shkrihet në zhurmën e diskutimit dhe në poteren e tij. Pas kësaj, vazhdon një kohë e gjatë dhe të pranishmit, duke qenë të preokupuar me përgjigjet, shpërqendrohen ndaj ezanit dhe ndaj kryerjes së namazit dhe vazhdojnë diskutimin rreth Islamit dhe interesimit ndaj tij. Koha e

namazit gati po mbaron, ndërkohë që ata vazhdojnë në prokopinë me diskutimin e tyre. Në fund, njëri prej tyre propozon një pushim prej pak minutash me qëllim që të kryejnë faljen e namazit. Namazi fillon me nxitim, duke mos kryer më shumë se rekatet e farzit. Tani shqyrto në aspektin e jashtëm të namazit të tyre. Nuk ka dyshim se secili prej tyre është drejtuar me mendjen e tij te diskutimi rreth të cilit ata fantazuan! Sapo të japin selamin e namazit, ata kthehen te njëri-tjetri. Gjatë namazit njëri ka kujtuar atë çfarë kishte harruar gjatë diskutimit. Te kujtesa e një tjetri ndodhi vështirësia dhe ngatërresa e perceptimit të tij te leximi i Sures El-Fatiha. Diskutimi i tyre rreth Islamit dhe problemeve të tij fillon përsëri. Por ata harruan se prapa namazit që e kryen ndodhen edhe Tesbihate, Dhikri dhe duatë. Sigurisht, namazi ka pjesë plotësuese të njëpasnjëshme dhe nafile. Çdo gjë prej diskutimit në të cilin ata u zhytën nuk është veçse mjet për këtë qëllim të madh; dhe kështu me radhë. Ti mund të marrësh shembuj të tjerë në këtë mënyrë. Megjithatë, ajo që është më e rëndësishmja, në vetë këtë përshkrim, është se shumë myslimanë sot e mbrojnë këtë mënyrë dhe filozofojnë në thirrjen për tek ajo dhe janë të bindur dhe i bindin edhe të tjerët se 'Islami nuk është tjetër veçse ky aspekt i jashtëm prej lëvizjeve formale, i cili stampohet mirë në studimet ideologjike, në diskutimet teorike dhe në organizimet protokollare'. Kështu, ata vazhdojnë duke e zvogëluar rëndësinë e ibadetit, të virgjërisë dhe të llojeve të Dhikrit, duke pandehur se ato janë mallra të njerëzve të zakonshëm dhe të të paditurve, të cilët nuk kanë punë tjetër dhe me to mbushin boshllëkun e kohës së tyre.

Mua më kujtohet një tubim i madh në njërin prej vendeve tona arabe. Unë isha njëri prej të pranishmëve në atë tubim. Më kujtohet se një mendimtar prej dijetarëve të shquar mbajti një fjalim në atë tubim. Midis të tjerave, ai tha: "Problemi i shumë myslimanëve sot është mendimi i tyre se Islami është 'që njeriu të kryejë sa më shumë namaz, ose të bëjë sa më shumë adhurim, ndonëse Islami është punë dhe ndërtim'". Unë nisa të kthehesha nga ana e djathtë dhe e majtë me qëllim që të shikoja fytyrat e të pranishmëve. Pastaj nisa të meditoja rreth natyrës së njerëzve të të gjithë atij qyteti. Ajo tek e cila më drejtuan sytë e mi dhe tek e cila më çoi mendimi im ishte se atje ndodheshin njerëz të cilët ishin shkëputur nga jeta e dynjasë dhe gjendeshin nëpër shpella të largëta për adhurim e namaz me pak rekate prej nafileve plotësuese. Atëherë, cili është aspekti i nevojës për këtë fjalë? Cila është domosdoshmëria që të bën thirrje për ta bërë të urryer namazin, ose për të bërë thirrje për t'i pakësuar adhurimet ndërkohë që të gjithë të pranishmit në vend ishin neglizhentë deri në minimum? Çudia është se, pas kësaj ne bëjmë thirrje për punë, ndërtim e vetëflim. Cila është ajo që i bën myslimanët ta realizojnë të gjithë atë, ndërsa janë të lidhur me peshë e pranga prej epsheve, fantazive dhe prej lakmive të ndryshme të dynjasë!? Cila është ajo që më nxit mua për të shkuar pas epsheve dhe

fantazive të mia dhe që zemra ime regëtin me dashurinë e tyre dhe me lidhjen pas tyre? Padyshim, çështja ka nevojë për ndihmë e për mbështetës. Por ku janë ky ndihmës e mbështetës dhe cilët janë? Deklarata Hyjnore i është përgjigjur kësaj dhe ka vendosur para duarve tona ndihmësin dhe mbështetësin. Kjo është te Fjala e Allahut, "Dhe kërkon ndihmë me durim dhe me faljen e namazit. E është e vërtetë se kjo është tejet e rëndë dhe e vështirë përveç besimtarëve që i frikësohen (ndëshkimit) të Tij". (El-Bekareh, 2: 45). Krijuesi e vendosi këtë ilaç ndihmues para duarve të të dashurit të Tij, Profetit Muhamed, sa herë që rëndohej çështja, ose sa herë binte ndonjë telash i rëndë, ose zgjoheshin në nefsin e tij disa ndjenja njerëzore. Shqyrtoje, për shembull, Fjalën e Allahut drejtuar Pejgamberit të Tij: "Bëj durim për gjithçka që ata thonë dhe lartëso lavditë e Zotit tënd para lindjes së diellit dhe para perëndimit. Edhe gjatë një pjese të natës lavdëroje Atë, si edhe pas faljeve-sexhdeve". (Kaf, 50:39-40). Hidhe vështirimin edhe te këto ajete të tjerë: "Kështu që ji i duruar dhe nënshtror urdhrit të Zotit tënd, dhe mos iu bind asnjë mëkatari ose mohuesi prej tyre. Dhe kujto Emrin e Zotit tënd çdo pasdite. Dhe gjatë natës bjer me fytyrë përtokë (në sexhde) për Atë dhe lavdëro Atë gjatë natës me falje të gjatë." (El-Insan, 76: 24-26).

Ruajna Zot, që Selefët tanë -të parët tanë- prej myslimanëve të ishin neglizhentë! Ata e forcuan dhe e mbrojtën këtë fe me heroizmat e tyre, me xhihadin dhe me vetëflimjet e tyre. Ata patën sukses në këtë veçse me heqjen e peshave të epsheve dhe prangave të fantazive prej vetvetes së tyre nëpërmjet armës së adhurimit, virgjërisë dhe qëndrimit në këmbë për orë të gjata, duke bërë ibadet para Allahut, në një pjesë të natës, duke derdhur lot të nxehtë, duke bërë lutje të përshpirtshme dhe duke e përmendur Atë me zemër të dridhur.

Për Zotin! Myslimanët e sotëm nuk do të mund të ecnin pas hapave të të parëve të tyre të djeshëm veçse në qoftë se dashuria do të mbushte zemrat e tyre, në qoftë se do të ndizeshin pasionet hyjnore mes krahëve të tyre, dhe në qoftë se do t'i mbushnin gotat e tyre me atë pije të lartë, e cila do t'i nxirrte ata prej errësirës së epsheve e të fantazive dhe të ngjiteshin lart me ndërgjegjen e tyre te niveli i së vërtetës më të lartësuar. Vetë zjarri i dashurisë është kërbachi shtytës dhe energjia lëvizëse. Vetë dashuruesi është ai që përpiqet me mallëngjim për tek i dashuri. Me këtë atij i lehtësohet vështirësia, ajo ia afron atij të largëtën, tek ajo asgjësohen forcat, në të shkrihet jeta, dhe nuk e sheh se ai e ka përmbushur premtimin e dashurisë apo e ka kryer detyrën e dhënies së falënderimit ndaj mirësisë. Në ditën që kjo dashuri të mbushë zemrat e myslimanëve të sotëm, atëherë plotësohet e gjithë struktura, përmbushet e gjithë puna, shfaqen mrekullitë e vetëflimit, të dhënies dhe të xhihadt, si dhe zbresin mrekullitë e ndihmës, krenarisë dhe të mbështetjes.

Shqipëroi nga Arabishtja: Jusuf Salkurti

Zekati

Zekati është detyrim për personat në moshë madhore, mendërisht të shëndoshë, të lirë, të mos kenë borxhe dhe përveç përballimit të nevojave të tij dhe të familjes të zotërojë pasuri në vlerën e nisabit mbi të cilin të kalojë një vit pa e prekur. Sasia e nisabit është kusht si për pasurinë ashtu dhe për prodhimin. Edhe pse ari dhe argjendi nuk shtohen, zekati jepet kur arrin vlerën e nisabit.

Nisabi: është një masë e caktuar nga feja për detyrimin e zekatit. Kjo masë është 85 gr ar, 595 gr argjend ose pasuri, mallra tregtie, para në vlerën e tyre.

Përsa i përket zekatit të kursimeve të parave, ajo është 2.5 % e vleftës totale të paprekur për periudhën njëvjeçare. Zekati i kafshëve ndryshon nga lloji i tyre. Tek të imtat është një në dyzet; tek devetë një në pesë; tek të trashat (lopë) një në tridhjetë. Edhe për mineralet jepet zekat.

MALLRAT QË MUND TË JEPEN ZEKAT

1 – Tek mallrat e tregtisë hyn çdo lloj malli si veshmbathje, ushqimet, bagëtite, shtëpitë, tokat dhe për të gjitha duhet të jepet zekat.

Bagëtite që mbahen për qëllime tregtie hyjnë brenda mallrave të tregtisë dhe për to jepet zekat në masën 2.5 %.

Zekati i mallrave të tregtisë llogaritet 2.5 % e gjithë vlerës së mallit që zotëron personi. Ky zekat mund të jepet në para ose në vlera të tjera.

2. Zekati i bagëtive

Bagëtite i ndajmë në grupe dhe ndarja e zekatit bëhet sipas grupeve të caktuara në vlerën e caktuar.

3 – Pasuria monetare

Stolitë të cilat përdoren për qëllime tregtia kanë nisabin e përcaktuar, në ar 85 gram ndërsa në argjend 595 gram. Secili person që zotëron këtë sasi të caktuar duhet të japë zekat 2.5 % të mallit. Edhe ata që kanë bono apo letra me vlerë, zekatin e japin duke llogaritur 1/40 e vlerës së mallit që kanë.

4. Pasuritë e patundshme

Përsa i përket personave që kanë shtëpi me qera, diskutohet nëse duhet dhënë zekat mbi vlerën e qerasë apo mbi vlerën e pasurisë. Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit të jepet mbi vlerat personale. Disa dijetarë e përngjasojnë vlerën e qirave me sasinë e mallrave bujqësorë dhe mendojnë se duhet të jepet 1/10 ose 1/20 e vlerës së qirasë. Ndërsa të tjerë mbështesin mendimin e dhënies 1/40 e vlerës së pasurisë së patundshme.

5. Mineralet

Sasia e nisabit për minerale si ari, argjendi, mermeri, smeralde, rubinë, naftë apo gaz natyror është 1/5 ose 20 % e mallit që zotëron personi.

6. Prodhimet bujqësore

Tek prodhimet bujqësore kemi dy lloj ndarjesh: nëse tek toka ku mbillet bëhen shpenzime si ujitja, përdorimi i ilaçeve apo ndonjë lloj shpenzimi tjetër, atëherë zekati është 1/20, ndërsa nëse marrim prodhime pa pasur asnjë shpenzim, është 1/10.

ZEKATI (Lëmosha Pastruese)

Bamirësia shprehet në Islam në forma të ndryshme. Ndërsa sadakaja (bamirësia) është një akt vullnetar, zekati është një detyrim për çdo musliman i cili zotëron një nivel të caktuar pasurie. Fjala zekat rrjedh nga fjala tezekka që do të thotë “të pastrosh diçka.” Prandaj zekati nënkupton mbajtjen e pasurisë të pastër dhe të shenjtë duke u dhënë 2.5 përqind të saj të varfërve. Rrjedhimisht ky akt e bën besimtarin dhe pasurinë e tij të qëndrojë përherë në nivele pastërtie dhe sinqeriteti (Tevbe 9:103). Zekati është një shtyllë shumë e rëndësishme e praktikës Islame dhe kjo vërtetohet nga barazimi që i bëhet asaj me namazin, gjithsej 82 herë në Kur'an.

Allahu ka premtuar se pasuria nuk do të pakësohet kurrë për shkak të dhënies së lëmoshës.

Thuj: “S’ka dyshim se Zoti im është Ai që i jep furnizim të begatshëm atij që do nga robërit e vet dhe Ai ia pakëson atij, e çka do që të jepni, Ai e kompenson atë dhe Ai është dhuruesi më i madh. (Sebe 34:39)

Zekati përbën një formë të detyrueshme bamirësie të marrë nga kursimet e një personi. Ai nuk është një taksë mbi të ardhurat, por një taksë mbi kursimet. Përfituesit më të mëdhenj të tij janë punëtorët e varfër të cilët nuk mund t’i plotësojnë të gjitha nevojat e tyre pa njëfarë ndihme shtesë, si dhe të mjerët të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë as edhe mjetet bazë të jetesës. Ai përdoret gjithashtu për të paguar borxhet e atyre të cilët nuk kanë mundësi t’i pagujnë vetë, për lirin e skllevërve dhe të robërve të luftës.

Zekati është gjithashtu një virtut i rëndësishëm i muslimanëve, siç përshkruhet edhe në ajetin e mëposhtëm kuranor.

“Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do ti mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjës, i urtë.” (Tevbe 9:71)

Shkëputur nga libri ‘Ilmihal i zgjeruar’, Botim i tre komuniteteve fetare

Sadakaja e Fitrit



Fitr do të thotë krijim, natyrë, mbyllje e agjërimit, etj. Sadakaja ose lëmosha e fitrit quhet shkurt edhe fitre. Sadakaja e fitrit është një adhurim pasuror (material) që e kanë për detyrë ta zbatojnë myslimanët që zotërojnë pasurinë e quajtur nisab (përveç nevojave të përditshme) si dhe personat që kanë nën kujdestari, të cilët arrijnë bajramin e ramazanit.

Dhënia e sadakasë së fitrit është vaxhib. Sadakaja e fitrit është një përgjegjësi e mbështetur mbi numrin e personave të familjes të përbërë nga kryefamiljari ose kujdestari dhe personat që ka nën kujdestari. Kurse shkaku i konkludimit të sadakasë së fitrit si vaxhib, e shprehur teknikisht, është arritja e personit deri në ditën e parë të bajramit të ramazanit.

Në shumë hadithe, Profeti (s.a.s.) ka urdhëruar dhënien e sadakasë së fitrit. Një hadith profetik i rrëfyer nga Abdullah b. Omeri, është kështu: "I Dërguari i Allahut e ka caktuar sadakanë e fitrit 1 sá (3.350 kg) hurma dhe 1 sá elb për person (mashkull, femër, të madh, të vogël) dhe ka urdhëruar të jepet para se njerëzit të dalin për të falur namazin e bajramit (të ramazanit ose fitrit) (Buhari, Zekat, 76; Muslim, Zekat, 12).

Sadakaja e fitrit është një adhurim që ka zënë vendin e vet në fe si një falenderim ndaj dhuntisë së jetës dhe trupit të favorizuar nga Allahu për personin dhe personat që ai ka nën kujdestari. Prandaj mbajtja e agjërimit nuk është kusht që sadakaja e fitrit të jetë ose të bëhet vaxhib. Edhe ata që s'mbajnë agjërime ose që s'munden të mbajnë agjërime, e kanë vaxhib të japin sadaka fitri. Sadakaja e fitrit bart edhe kuptimin e falenderimit ndaj Allahut të Lartë që i bëri myslimanët, të cilët mundën ta plotësojnë atë vit adhurimin e agjërimit, të aftë për ta kryer këtë adhurim.

Në të njëjtën kohë, siç bëhet e ditur në hadithin profetik, për myslimanin që ka mbajtur agjërime, sadakaja e fitrit plotëson mangësitë e adhurimit të tronditur me sjellje që s'i kanë hije personit të agjëruar. Gjithashtu, sadakaja e fitrit siguron pjesëmarrjen e të varfërve në gëzimin e bajramit (Ebu Davud, Zekat, 17; Ahmed b. Hanbel, Musned, 2/277). Veçanërisht, është thënë se dhënia e sadakasë së fitrit është shkak për pranimin e agjërimit, për shpëtim, për lehtësimin e vuajtjeve të çastit të vdekjes dhe të varrit.

Kushtet e përgjegjësisë për dhënien e sadakasë së fitrit

Të jesh mysliman. Për një person, dhënia e sadakasë së fitrit bëhet vaxhib në qoftë se është mysliman.

Të kesh pasuri në masën nisab. Për një person, që të bëhet përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit, duhet të zotërojë, mbi nevojat themelore, pasuri në masën nisab, ekuivalente me vlerën e 85 gr flori ose 595 gr argjend. Ndryshe nga zekati, që sadakaja e fitrit të jetë vaxhib, nuk është kusht që pasuria (mbi nevojat themelore) që zotëron personi të jetë rentabël (shtuese) dhe që të ketë qëndruar në dorë të tij një vit. Sipas shkollave shafite, malikite dhe hanbelite, për të qenë përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit, nuk është kusht që personi të zotërojë pasurinë në masën nisab. Çdo mysliman i cili, përveç nevojave themelore, ka aq ushqim sa t'i mjaftojë për natën dhe

ditën e bajramit, është përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit.

Përgjegjësia e dhënies së sadakasë së fitrit. Për të qenë përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit nuk është kusht që personi të ketë mbushur moshën e pubertetit dhe të ketë zhvillim mendor normal. Sipas Ebu Hanifesë dhe Ebu Jusufit, sadaka fitri duhet dhënë edhe për fëmijën dhe të sëmurin mendor që zotërojnë pasuri në masën nisab.

Përkatësia gjinore dhe kujdestaria. Që dikush të jetë përgjegjës për dhënien e sadakasë së fitrit për persona të tjerë, duhet që personat e tjerë të jenë pjesëtarë të familjes së tij ose nën kujdestarinë e tij.

Koha e dhënies të sadakasë së fitrit

Sadakaja e fitrit mund të jepet që me hyrjen e muajit të Ramazanit. Në përputhje me qëllimin e plotësimit të nevojave të të varfërve, të shprehur në hadithet e Profetit (s.a.s.), dijetarët kanë nxitur dhënien e sadakasë së fitrit një a dy ditë para bajramit. Nuk është e përshtatshme që dhënia e sadakasë së fitrit të lihet pas ditës së parë të bajramit. Megjithatë, edhe në qoftë se mbetet për t'u dhënë pas bajramit, përgjegjësia e dhënies së fitrit vazhdon dhe duhet kryer në rastin më të parë.

Sipas shkollës shafite, vonimi pa justifikim i dhënies së sadakasë së fitrit pas ditës së bajramit është haram.

Sasia e sadakasë së fitrit

Siç u përmend edhe më parë, në hadithet lidhur me sadakanë e fitrit bëhet e ditur se, në kohën e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), ky adhurim pasuror është kryer në sasinë 1 sá (njësi mase prej 3.350 kg) nga lëndët ushqimore të përdorura më shumë në atë periudhë, si hurma, elbi, rrush i thatë, etj. Veç kësaj, rrëfëhet se sipas praktikës së sahabeve, mes të cilëve ndodheshin edhe kalifët rashidinë, është dhënë sadaka fitri në grurë në masën 1/2 sá.

Personat të cilëve mund t'u jepet sadakaja e fitrit

Vendet ku mund të jepet sadakaja e fitrit me vendet ku mund të jepet zekati, janë të njëjta. Nisur nga kjo, personave që nuk mund t'u jepet zekat, nuk mund t'u jepet as sadaka e fitrit.


Personat që nuk mund t'u jepet zekat janë këta: personat që konsiderohen fetarisht të pasur (që zotërojnë sasinë nisab pavarësisht nëse është rentabël apo jo), gruaja e personit që jep fitrë, të afërmit bazë (nëna-babai, gjyshja-gjyshi), të afërmit e nivelit të dytë (fëmijët, nipërit dhe mbesat), të afërmit që ka nën kujdestari. Personi që jep sadakanë e fitrit, duhet t'u japë përparësi të varfërve të vendit apo mjedisit ku banon, farefisit që mund të banojë edhe larg, të varfërve me moral të mirë dhe nxënësve.

Personi që jep sadakanë e fitrit, mund t'ia japë atë si një të varfëri të vetëm, ashtu dhe duke ua shpërndarë disa të varfërve. Por, për sa i përket përballimit të nevojave të personit të varfër, dhënia një të varfëri është më e mirë. Ndërkaq, disa persona mund t'ia japin fitret një të varfëri të vetëm.

Shkëputur nga libri "Ditët dhe Netët e mira në Islam"
Këshilli Botues, KMSH

BAJRAMI

Qhe simbolika e tij



Megjithëse i shkurtër, Bajrami është një pjesë e bekuar kohe që mbart në vetvete begatinë, mirësinë dhe gëzimin e javëve, madje të muajve të tërë.

Bajrami është një lehtësim i shpirtit, është kënaqësia e brendshme që buron prej shpresës së përmbushjes së adhurimit dhe përfitimit të faljes prej Allahut, Mëshiruesit Fuqiplotë.

Bajrami është dita ku takohet forca e të pasurit me dobësinë e të varfrit në dashuri, mëshirë dhe drejtësi e sendërtuar në zekat, bamirësi dhe përkrahje.

Bajrami është dita e lehtësimit të brengave, është dita e shpresave të reja, është dita e të kujtuarit për njëri-tjetrin, është dita e një jete të re, e pendesës për gabimet dhe e projekteve të veprave të mira, dita kur meritë, hatërmбетjet, xhelozia dhe smira marrin fund, është dita kur falen gabimet e të tjerëve, dita e ripërtëritjes së vëllazërisë, miqësisë dhe dashurisë për njeriun dhe njerëzoren. Bajrami është solidarizim me masat. Për ata që nuk kanë asnjë mundësi materiale është buzëqeshje, është përkrahje sociale, është lutje e sinqertë për çdokënd.

Bajrami është simbol i paqes, i qetësisë shpirtërore, i lartësimit të Allahut dhe i shpresës së arritjes së kënaqësisë së Krijuesit, që është qëllimi final për besimtarin.

Në Bajram ka një përkujdesje tjetër hyjnore, ka një këndvështrim plot surpriza prej përtej qiejve, të tillë që nuk mund të arrihet në dhjetëra ditë apo javë e madje edhe më shumë që nuk janë Bajram.

Ne e dimë që çdo mirësi dhe adhurim merr vlerë në masën e pranimit dhe këndvështrimit që Allahu ka në të, prandaj mund të themi që Bajrami është kohë gëzimi, sepse Allahu kështu e ka kërkuar të jetë. Padyshim që ky gëzim është i lidhur dhe në përpjesëtim të drejtë me vlerësimin dhe njohjen e domethënies së bukurive dhe gëzimit që Bajrami pëshpërit ëmbël në shpirtin e besimtarit.

Botëkuptimi dhe pritshmëria jonë prej Bajramit është sihariqi i faljes. Bajram i

vërtetë për besimtarin është pastrimi prej mëkateve. Është e pamundur të konceptojmë me receptorët tanë lëndorë këndvështrimin dhe trajtimin e posaçëm që Allahu na ka premtuar, por ne i besojmë aq fort premtimit të Tij, sa që duket sikur e ndiejmë aromën e mirësive që Ai ka përgatitur për ne. Për dikë që nuk e njeh botën plot mister të besimit këto mund të duken si fantazi dhe romanca, ndërsa zemrat që kanë provuar ëmbëlsinë e besimit, e dinë fare mirë se Allahu që na solli prej hiçit në ekzistencë, që na dhuroi jetën dhe aftësinë ta jetojmë atë, që na krijoi si njerëz dhe jo diçka tjetër, që na vuri në shërbim diellin e hënën, qiellin e tokën e çka mes tyre, që na dha mirësi pa fund e pa u kursyer, padyshim që do të na ringjallë në botën e amshuar për të na falur më shumë, sa të na habisë e të na mrekullojë me surpriza që, bazuar në përshkrimin profetik, nuk kanë mundur të hyjnë as në imagjinatën tonë.

Ne besojmë në madhësinë e Zotit, besojmë që thesaret e pasurisë së Tij nuk mbarojnë, sikurse besojmë që Ai do të na japë shumë e shumë herë më tepër se pritshmëritë tona.

Festa jonë e Bajramit nuk i ngjan festave të kulturave të tjera. Edhe në Bajram qëndrimi i besimtarit reflekton seriozitet me gjithë gëzimin që Bajrami i dhuron, në sjelljet e tij nuk ka tepri, në lëvizjet e tij nuk mungon ekuilibri, ai feston, por nuk llastohet, në këndvështrimin e tij pasqyrohet edukata kur'anore.

Sikurse në kohët e tjera edhe në Bajram besimtarët janë të hapur ndaj urdhrave të Allahut dhe të të Dërguarit. Kështu në marrëdhëniet me të tjerët ata karakterizohen nga ndjenja e dhembshurisë, dashurisë dhe respektit.

Bajrami është festë, është simbol i gëzimit, i paqes dhe i mirësisë. Zoti kështu e ka zgjedhur, prandaj neve na takon ta vlerësojmë.

"E kush madhëron dispozitat (simbolet) e Allahut, ajo është shenjë e devotshmërisë së zemrave" (Haxh, 32).

Le të gëzojmë dhe ta shijojmë me shpirt e me zemër këtë festë të bukur e plot hijeshi.

Bajrami dhe fëmijët

ROLI I SHKENCËS NË ORGANIZIMIN E ATMOSFERËS SË BAJRAMIT

Myslimanët anëekënd botës, së shpejti do të festojnë Fitër Bajramin. Edhe pas këtij bajrami, në mesin e shqiptarëve myslimanë pa dyshim do të dëgjohen komentet: “po edhe gjatë këtij Bajrami mungoi atmosfera festive”, dhe “bajramët nuk janë si kanë qenë dikur”, duke treguar në këtë mënyrë keqardhje për atmosferën festive të bajramëve të dikurshëm. Karima Burns në punimin që po e sjellim me këtë rast, përpiket të aktualizojë këtë problematikë dhe duke shfrytëzuar arritjet e shkencës bashkëkohore dhe mësimet psikologjike të paraqitura për myslimanët e hemisferës Perëndimore me këshilla praktike se si bajramin ta bëjmë të këndshëm për shpirtat tanë, zemrat, sytë dhe veshët, kënaqësi e cila do të mbetet përgjithmonë në kujtimin e bukur të çdo myslimani, sidomos të vegjëlvë tanë. (Përkthyesi)

Myslimanët në Amerikë dhe në Perëndim e dinë mirë si duket atmosfera e Krishtlindjeve. Çdo dhjetor përderisa shëtisin nëpër qendrat tregtare, rrugëve dhe dyqaneve, në ajër përhapet aroma e ëmbëlsirave, pishave dhe cimetit të Krishtlindjeve. Pa dyshim bile edhe myslimanët që nuk jetojnë në Amerikë hapin sytë në titujt e gazetave dhe pyesin: për çfarë janë të gjithë të emocionuar? Ndërsa ne si myslimanë natyrisht pyesim në çfarë mënyrë si tek fëmijët tanë mund të zgjojmë këso ndjenja emocionesh kur është në pyetje Bajrami?

Atmosferën e Krishtlindjeve është vështirë ta “kopjojmë”. Mirëpo, myslimanët mund të krijojnë atmosferën e bajramit e cila fëmijëve të tyre do t’u sjellë gëzim dhe mbush zemrat e tyre, bile edhe në mesin e pishave të Krishtlindjeve dhe sajave të babadimrit.

Në fund, e tërë kjo është gjë e shkencës. Studimet kanë treguar se shfrytëzimi i të gjitha shqisave tona është mënyra më e mirë për të pushtuar informatat dhe tërësisht “me ngjallë” një ndodhi. Një festë, duhet të zgjojë te individit të gjitha shqisat: zemrën, imagjinatën, intelektin, syrin, veshin, shqisën e shijes, si dhe shqisën e aromës dhe prekjes.

Fëmijët mësojnë që të ndiejnë gëzim dhe emocione gjatë secilës Krishtlindje, në realitet për arsye se këtë festë e duan me të gjitha shqisat e tyre. Me zërin e tyre këndojnë këngë të krishtlindjeve, duke shfrytëzuar imagjinatën e tyre dëgjojnë tregime për babadimrin, me zemër luten, me gjuhë shijojnë ëmbëlsirat, me vesh dëgjojnë këngët e krishtlindjeve, me duar prekin gjilpërat e pishës, me shqisën e të nuhaturit ndiejnë aromën e ëmbëlsirave dhe cimetit, ndërsa në secilin kënd shihen shtëpitë e zbukuruara me drita. Duke shfrytëzuar shkencën edhe ju të njëjtën ndjenjë mund të krijoni tek fëmijët tuaj gjatë Bajramit.

Shqisa e të nuhaturit është shqisa më e rëndësishme kur është në pyetje festimi. Ekziston një lidhje shumë e fortë në mes shqisës së nuhaturit dhe memories. Procesuirimi i aromës është direkt i lidhur me sistemin limbik ku është e vendosur memoria dhe emocionet.

Në realitet shqisa e të nuhaturit është shumë e fuqishme saqë ky kapacitet i saj shfrytëzohet në disa shkolla për të përshpejtuar procesin e mësimin.

Nëse shikojmë pas në histori, do të shohim që shqisa e të nuhaturit për këtë qëllim është shfrytëzuar gati në të gjitha kulturat dhe religjionet. Kështu kisha ortodokse greke njihen filozofinë e “përfshirjes” të gjithë pesë shqisat në shërbesën rituale. Për të tërhequr shqisën e të nuhaturit



p.sh. ndizet timjani. Përtë filluar javën e re në hebreizëm gjatë ritualit Havdali i cili mbahet në fund të Sebatit, shfrytëzohet kutia me erëza. Për këtë qëllim përdoren zakonisht erëzat e forta dhe me aromë të këndshme sikur cimeti, miroxhia dhe kardamomi.

Boston Globe për këtë qëllim paraqiti që tek personat që i takojnë të njëjtës kulturë por gjeneratave të ndryshme, ndjenja e nostalgjisë nxitet me aroma të ndryshme.

Ata që janë lindur më 1920, 1930 dhe 1940 kanë këtë ndjenjë kur ndiejnë aromën e luleve, ajrit të detit, barit të kositur dhe gjetheve të djegura, ndërsa ata që kanë lindur më 1950, dhe 1970, bëhen nostalgjikë kur ndiejnë aromën e mjeteve për pastrim e dritareve, llakut për flokë, kremit për diell dhe flamasterit.

Gjithashtu edhe myslimanët dëshirojnë që fëmijët e tyre të ndiejnë më tepër nostalgji për aromën e bajramëve se sa aromën e krishtlindjeve ose disa festave tjera perëndimore.

Një prej gjërave e cila ka aromë të këndshme gjatë ditëve të Bajramit është dreka e Bajramit. Mirëpo, për të ngulitur një ngjarje fuqishëm në memorien tonë atëherë bashkë me të në një mënyrë duhet "lidhur ndjenjën karakteristike të aromës". Për këtë arsye, gjatë bajramit myslimanët nevojitet të përpiqen të bëjnë gjella të shijshme me aroma të forta në përgatitjen e të cilave shfrytëzohen erëza të ndryshme aromatike siç është cimeti, karafili, majdanozi, etj.

Përveç aromës së gjellës, atmosfera gjithashtu duhet zbkuruar edhe me aroma të tjera të këndshme. Për këtë qëllim mund të shfrytëzohet vaji eterik, ose timjani, por që aroma duhet të jetë e veçantë dhe karakteristike për bajram. Gjithashtu mund të shfrytëzohet edhe vaji i trëndafil. Si alternativë secili person për vete mund të bëjë kombinimin individual të vajrave. Kështu që të ketë parfumin personal për ditët e Bajramit (ose në hapësirat e shtëpisë së tij) mund të rregullojë atmosferën festive specifike. Bergamoti me një dozë të limonit ose tangerinës do të ishte kombinim i përkryer për disponim festiv.

Të gjitha këto kombinime të aromave mund të shfrytëzohen ose në formë timjani ose parfumi.

Natyrisht, shqisa e të nuhaturit shkon dorë për dorë me shqisën e të shijuarit. Në realitet shqisa e të shijuarit është e njohur për drekën e Bajramit.

Receptorët për shije apo gustativë për çdo javë deri dhjetë ditë shpenzohen, e sidomos pas pesëdhjetë vjetëve të jetës. Me plakje shqisa e shijës nuk është aq e mprehtë.

Në këtë mënyrë pjesa e përvojave më të mëdha gustative pa mëdyshje do të mbetet gjithmonë e mbyllur në shqisën e të nuhaturit. Natyrisht, nëse dëshirojmë që ta shfrytëzjmë maksimalisht këtë shqisë, atëherë përgatitja e veçantë e "ushqimeve të Bajramit" sikur që janë ëmbëlsirat ose tortet e Bajramit do të ishte gati një opcion i përkryer.

Shqisa e të parit është shqisë vijuese shumë e rëndësishme. Afro 70% të receptorëve tonë të shqisave

janë të vendosur në sy dhe nëpërmes shikimit të botës në të cilën jetojmë ne arrijmë ta vlerësojmë dhe kuptojmë.

Me parë që të gjithë janë në rroba të reja është kënaqësi për sytë. Mirëpo, myslimanët të cilët jetojnë në mesin e veshjes së perëndimoreve ndonjëherë zvogëlojnë rëndësinë e rrobave të zbkuruara të Bajramit dhe kështu fëmijëve të tyre me rastin e festës së Bajramit iu blejnë rroba të reja xhins ose fanela të zakonshme. Në vend të kësaj, ata në këto ditë të bukura fëmijëve më të vegjël duhet t'i blejnë rroba të zbkuruara me ngjyra të shumta të gëzueshme.

Në këtë kontekst, në shumë vende të Lindjes së Afërt mundësitë e shqisës së dëgjimit pranohen si fakte të gatshme, ndërsa myslimanët në Evropë dhe Amerikë, mjerisht, zakonisht të njëjtat i harrojnë.

Në Egjipt si dhe në shumë vende arabe, gjatë kohës së Bajramit nëpër rrugë dëgjohen tingujt e tupanëve dhe muzikës nga radio. Në përfundim ku në muzikën e fortë në vendet publike zakonisht shikohet me kritikë, myslimanët në realitet mbesin të privuar nga tingujt e Bajramit. Për këtë myslimanët që nuk kanë traditën e muzikës së bajramit, tani një të tillë duhet ta ndërtojnë. "Muzika" e parë që duhet pasur parasysh është gjithsesi melodija e Kur'anit. Pastaj për të rinjët dhe të moshuarit mund të zgjidhen ilahi të ndryshme me të cilat do të zbkurohej atmosfera festive e Bajramit.

Në këtë kuptim, me shqisën e të prekurit është vështirë me manipuluar. Mirëpo, pas shqisës së të nuhaturit pa dyshim kjo është shqisa më me rëndësi. Kjo për shkak se lëkura është organi trupor më i madh, pesha e të cilës arrin 2.5 deri në 4.5 kg.

Përveç kësaj, studimet e shumta kanë treguar se shqisa e të prekurit është me rëndësi kruciale për zhvillimin e fëmijut. Kështu shqisa e të prekurit është çelës i ekzistencës sonë dhe ndoshta edhe çelës i ekzistencës së bajramit në përfundim.

Përjetimin e Bajramit nëpërmes shqisës së të prekurit, myslimanët të fëmijët e tyre mund ta përshpejtojnë duke iu blerë dhurata të bëra nga leshi i butë apo nga materiali i mëndafshit. Gjatë kohës së Bajramit fëmijët duhet përqaftuar më tepër se zakonisht dhe duke i nxitur gjatë faljes të kënaqen në përjetimin e sexhadeve të buta dhe tepihave të bukur të xhamisë.

Në fund duhet përmendur zemra dhe ndjenja e imagjinatës. Gjatë ditëve të Bajramit fëmijëve u duhet treguar ngjarje të ndryshme si ka qenë Bajrami i prindërve ose si shënohet Bajrami në vendet tjera.

Edhe pse sot mund të gjenden libra të shumtë ku janë përmbledhur tregimet e Bajramit, megjithatë, tregimet më të bukura do të ishin ato që janë të bazuara në përvojën personale.

Përktheu: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi



TERMI

“KITAB” – LIBRI

Fjala libër është formuar nga rrënja e foljes ‘ke-te-be’. Paskajorja e kësaj foljeje e cila është el- ketb,dhe do të thotë të lidhesh lëkurën në lëkurë ose një shtresë në shtresën tjetër me një litar. Në këtë kuptim ‘ketebtu’s-sekae’ do të thotë ‘e kam lidhur torbën’. Si term, vjen në kuptimin ‘të ngjiten shkronjat njëra me tjetrën me shkrim’. Në këtë kontekst, ajo i referohet lidhjes midis shkronjave dhe fjalëve. Në këtë aspekt, zërat që dalin nga goja me një gjendje të renditur, këta tinguj mund të quhen gjithashtu ‘libër’, nuk ka pse të shkruhen. Për këtë arsye, në bazë të këtij kuptimi, fjala e Zotit edhe nese nuk është e shkruar i thuhet ‘kitap’. Sepse, fjala ‘kitap’ e cila kalon shpesh ne Kur’an, jo gjithmonë e paraqet ose i referohet mënyrës së shkruar të Kur’anit; Fjalët e Zotit që tregojnë një renditje, unitet të vetëm quhen ‘shkrim’.

I gjithë universi është një tërësi fjalësh që ka ardhur në perfundim me fjalën ‘bëhu’ me fuqinë e Tij, dhe në këtë kuptim, universi me këto fjalë ka marrë gjendjen e një libri. Me pak fjalë, asgjë nuk mbeti mangut në Librin Kryesor (Levhi Mahfudh) që Allahu krijoi në Dijen e tij të përfjetshme. Në fakt, disa filozofë islam janë deklaruar se universi krijohet përsëri ose vazhdimisht nga Zoti në çdo moment dhe se ekziston një vazhdimësi midis këtyre krijimeve. Këtu kemi përdorur ‘kohën e shkruar’ për të kuptuar temën, dhe mund ta shprehim këtë me ‘kohën e tashme’ dhe ta zgjasim/shtriejm atë gjatë gjithë kohës.

S’ka asnjë kafshë në Tokë e të gjitha shpendët që fluturojnë me krahët e tyre, që të mos jenë në një grup të ngjashëm me ju (në krijim dhe ekzistim). Ne nuk kemi harruar asgjë në Libër (Levhi Mahfudhin)”. Pastaj do të tubohen te Zoti i tyre. (En’am: 38)

Perëndia i ka çelësat e të gjitha fshehtësive dhe vetëm Ai i di ato. Ai di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai, dhe nuk ekziston asnjë kokërr në thellësitë e tokës, as e freskët as e thatë, e të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Levhi Mahfudh). (En’am: 59)

Gjithçka e shkruar dhe gjykuar me krijimin del në kohën e duhur; Çfarëdo që po ndodh në të gjithë universin, patjetër që po ndodh sipas këtij shkrimi (përcaktimi).

S’ka mjerim (fatkeqësi) që e godet Tokën dhe juve, përveç asaj që është shënuar më parë në Libër, - kjo për Perëndinë, me të vërtetë, është lehtë! (Hadid: 22)

Kjo do të thotë, origjina e Librit, burimi, është dija e Allahut. Çdo qenie në univers dhe çdo ngjarje që ndodh ndodhët në njohjen e para-përjetësisë së Allahut. Kur’ani kësaj dije i referohet me emra të cilat kanë një kuptim të përbashkët si ‘Kitab-libër, Ummu’l kitab-nëna e librit, Levh-i Mahfudh, Imam Mubin. Universi është mënyra e hapjes së këtij libri, çdo moment që kalon, prej këtij librit del një pjesë tjetër në pah. Allahu gjatë gjithë historisë, kohë pas kohe këtë libër, e ka dërguar te njerëzit në formë të përmbledhur prej shkronjave që krijohen fjalët, prej fjaleve që krijohen ajetet, dhe prej ajeteve që formohen suret nëpermjet pejpgambereve që ka zgjedhur në mesin e njerzëve. Në këtë kuptim, librat e shejtë si Tivrati, Inxhili dhe Kur’ani mund të thuhet se janë shpjegim i mbledhur në faqet e universit. Çdo gjë në univers, dhe çdo ngjarje që do të ndodhë edhe në keto libra ka sferë dhe thelb. Tani, në dritën e kasaj diturie themelore, për rendësinë dhe kuptimin e librit, le ta shikojmë edhe me kuptime tjera anësore;

1. Libri, ashtu siç e kemi theksuar me siper vjen me kuptim i shkruar ne faqe: E, sikur Ne ta zbritnim ty një Libër të shkruar në letër; e ata ta preknin me duart e tyre, ata që nuk besojnë, me siguri do të thonin: “Kjo s’është gjë tjetër, përpos një magji e hapët”. (En’am: 7)

2. Libri, po ashtu perfshin edhe kuptimin një herë të kerkohet pastaj te krijohet: Perëndia ka shkruar (në Librin e shenjtë “Levhi Mahfudh”): “Unë dhe profetët e Mi do të fitojmë me siguri!” – Perëndia, me të vërtetë, është i fortë dhe i Plotëfuqishëm. (Muxhadele: 21)

3. Libri vjen në kuptim, ‘të qeveris dhe të obligoj: E,

ata që u bënë besimtarë më vonë, - që emigrojnë dhe luftojnë bashkë me ju, - ata radhiten me ju, kurse ata (besimtarë) që janë në lidhje farefisnore - sipas Librit të Perëndisë - janë më të afërt për njëri-tjetrin. Me të vërtetë, Perëndia është i dijsëm për çdo gjë. (Enfal: 75) Ju është urdhëruar agjërimi... (El-Bekareh: 183) namazi, është detyrë e obligueshme për besimtarë në kohë të caktuar. (En-Nisa: 103)

4. Libri, 'të besh të futesh brenda në të: Regjistrona neve bashkë me dëshmitarët! (Ali Imran: 53)

5. Po ashtu libri vjen edhe në këtë kuptim 'një argument i dërguar nga Zotit: Ka disa njerëz që polemizojnë për Perëndinë - pa kurrfarë dijenie, dhe pa kurrfarë baze dhe pa Libër të shenjtë. (Haxh: 8)

6. Me të vërtetë, një grup nga ithtarët e Librit përdredhin gjuhët e tyre (duke lexuar Librin), që të mendoni ju se ai farë leximi është prej Librit, e ajo në të vërtetë nuk është prej Librit. (Ali Imran: 78)

Në ajete, libri i parë në përgjethsi vjen në kuptimin si libër i Zotit; pra, Levh-i Mahfudh, Ummu'l-kitab, ose libri i universit po ashtu dhe me kuptim liber i Zotit sikur Kur'ani, Tevrati dhe Inxhili.

Libri i dytë, meqe ajeti flet në lidhje me hebretë atëherë është Tevrati, pra, në fakt mund të quhet 'meqe nuk është në Tevrat'. Sa i perket librit të tretë, është libri që flitet për librin e Zotit që hebretë e kanë shkruar me dorën tyre si në vend të Tevratit. 'Mjer ata që me duart e tyre shkruajnë vepër (të rrejshme)' (Bekara: 79)

7. Libri, po ashtu vjen edhe në këto kuptime 'shkrim, leterkëmbim, letër: E, ata që gjenden në pushtetin tuaj (skllavët dhe skllavet) që kërkojnë të lirohen (duke e kompensuar veten) shkruani (lidhni kontratën), nëse dini që janë të mirë. (Nur: 33) Shko me këtë letër timen. (Neml: 28)

8. Libër, do të thotë "Sheriat", ligjet e Zotit, pra në kuptim të përgjithshëm të vendimeve.

9. Libri po ashtu ka edhe një emër tjetër të rëndësishëm, ajo bëhet nga shkruarja e veprave të njerëzve gjatë jetës së tyre në dynja. Në Kur'an urdhërohet: 'Na do ta shenojme atë që flet' (Mejrem: 79) 'Do t'ia paraqesim atij në Ditën e Kijametit - librin që do ta gjejë të hapur: (i thuhet): "Lexoje librin tënd" (Isra: 13-14) Njerëzit në ditën e llogarisë do ta marrin librin e tyre sipas veprave që kanë bërë në dynja, nga e djathta, e majta ose nga mbrapa ose para, dhe këto ndahen në tri pjesë: të parët, të djathtët (shoku i djathtë) dhe të majtet (shoku i majtë).

Po, po, me të vërtetë, Libri i mëkatarëve është në Sixh-xhin, e, ata e di ti se ç'është Sixh-xhin? (Ai është) Libri i shkruar...Po, po, me të vërtetë, Libri i të ndershmeve është në Il-ljijn, E, a e di ti se ç'është Il-ljijn? Ai është Libri i shkruar që e dëshmojnë të afërmit (engjëjt) e Perëndisë. (Mutaffifin 7-9, 18-21) Këto ajete me të vërtetë janë shumë ndikuse në këtë pjesë. Njerëzit atë se çfarë punojnë n'dynja ajo pergatitet në një libër për ata se çfarë pozicioni do të kenë në Ahiret; krijon poste të larta dhe të thella për banorët e tyre. Çdo fjalë dhe vepër e njeriut

shkronje për shkronje, madje fjalë për fjalë ai e ndërton vendin e tij në Ahiret me 'shkrim'. Kur'ani është libri i fundit që është ruajtur ashtu siç ka zbritur prej Zotit, universin dhe çdo ngjarje në univers ai e permledh në shkronja dhe fjalë. Në të vërtetë, në Kur'an ka shume ajete që janë të përbashkëta me Kur'anin dhe Librin Kryesor: 'Elif, Lâm, Râ. Këto janë ajetet e Librit të qartë! Na e zbritëm këtë Kur'an në gjuhën arabe, për ta kuptuar ju.' (Jusuf: 1-2) 'Këto janë ajetet e Kur'anit dhe Librit të qartë' (Neml: 1) Në Kur'an aty ku kalon libri si (liber i hapur), në kuptimin e tij të përgjithshëm është Libri. Allahu ata që i bekoj me dijen e Tij prej këtij libri ata mund të sjellin një objekt/send sa hap e mbylle sytë nga qindra kilometra largësi: 'Ai, që ishte i pajisur me dijen e Librit - prezent te Sulejmani, tha: "Unë do të ta sjellë ty atë - sa çel e mbyll sytë." (Neml: 40)

Librat hyjnor njeriut i tregojnë rrugë, është lajmëtar, mëshirë, dhe për njerëzit që besojnë është burim i rrugës së drejtë. Këto libra janë dërguar për njerëzit që në çdo temë që ka mosmarrëveshje ata të japin gjykim sipas këtyre. Janë dërguar që të rregullojnë jetën e njeriut mbi 'Mizan (balancë) dhe Demir (autoritet). Qe ta nxjerrin njeriun nga errësira në dritë dhe nga zullumi për në drejtësi.

(Dikur) të gjithë njerëzit i kanë takuar një bashkësie (pastaj lindi mospajtimi ndër ta), dhe Perëndia u ka dërguar profetët si sihariques dhe si frikësues, dhe me ta dërgoi Libër në të cilin gjendej e vërteta, që me të, të gjykoreshin njerëzit për ato gjëra që nuk janë pajtuar. Mirëpo, njerëzit u grindën ndërmjet veti, pasi që u erdhën argumentet e qarta, nga zilia e njëri-tjetrit; dhe atëherë Perëndia, me autorizimin e Vet i udhëzoi besimtarët që ta kuptojnë të vërtetë, lidhur me atë që nuk u pajtuan ata. - Se, Perëndia e shpie në udhë të drejtë atë që don Ai. (Bekara: 213)

Me të vërtetë, Ne i kemi dërguar profetët Tonë me argumente të qarta dhe me ta u kemi dhënë librin dhe terezitë, (drejtësinë): që njerëzit të veprojnë drejt; kurse hekurin e kemi krijuar, se, në atë ka tmerr të madh, po edhe dobi për njerëzit dhe që Perëndia të dëftojë ata që ndihmojnë besimin e Tij dhe të dërguarit e Tij - pa i parë. Me të vërtetë, Perëndia është i fuqishëm dhe i madhërueshëm. (Hadid: 25)

Elif Lâm Râ. Ky është Libri, që ta kemi shpallë ty, që njerëzit t'i nxjerrish nga errësira në dritë, me lejen e Zotit të tyre, në rrugën e të Plotëfuqishmit dhe të Falenderueshmit. (Ibrahim: 1)

Na ta kemi shpallur ty Librin, vetëm që t'ju shpjegosh atyre atë për të cilën ata nuk pajtoheshin, dhe (që të jetë) udhërrëfyes dhe mëshirë për njerëzit që besojnë" (Nahl: 64)" E, para Kur'anit ka ekzistuar Libri i Musait - udhërrëfyes dhe mëshirë. E, ky (Kur'ani), Libër vërtetues (i librave të shpallur) në gjuhën arabe për t'i paralajmëruar ata që bëjnë zullum dhe për t'i siharikuar bamirësit. (Ahkaf: 12)

Përktheu: Haki Sahitaj



HAFIZ ALI ULQINAKU

(1855-1913)

Dokumentet e shumtë historikë dhe studimet rreth jetës e veprës së Hafiz Ali Ulqinakut nxjerrin në pah vlera të padiskutueshme të një niveli intelektual të denjë për një elitë jo vetëm për kombin tonë, por edhe më gjerë. Në fakt ka qenë vetë personaliteti i tij jo vetëm në shërbim të fesë, por edhe në shkrimin, ruajtjen e përhapjen e gjuhës shqipe, si dhe në mbrojtjen e trojeve shqiptare me armë në dorë, që ka shtyrë studiues të shumtë brenda dhe jashtë trojeve shqiptare, për t'u marrë me plot pasion me aktivitetin dhe veprat e Hafiz Ali Ulqinakut.

Hafiz Ali Ulqinaku është një figurë e shquar fetaro-atdhetare, që i përket periudhës së Rilindjes Kombëtare, por që nderohet në të gjitha trojet shqiptare. Lindi në vitin 1855, në Ulqin, në lagjen "Ranë", që ndodhet pranë detit. Është djali i Jakub Behlulit, që rrjedh prej një familje të njohur barkëtarësh. Ali Ulqinaku ishte një djalosh i zgjuar, kështu që babai i tij e dërgoi për të mësuar te dijetari më i njohur i Ulqinit, myderriz Salih Hylja. Myderriz Salih Hylja ishte një pedagog i dalluar, hafiz i shquar, atdhetar i dëshmuar. Në kohën e "Lidhjes së Prizrenit" (1878-1881), Hafiz Salih Hylja udhëhoqte degën e "Lidhjes së Prizrenit" në Ulqin. Hafiz Ali Ulqinaku, si nxënës i Medresesë, luftoi me pushkë në dorë përkrah profesorit të tij, Myderriz Salih Hylja, duke luftuar për liri dhe duke i mbrojtur trojet shqiptare nga Mali i Zi. Kur Mali i Zi i pushtoi trojet shqiptare, në vitin 1880 mbi 400 familje shqiptare u detyruan të largohen nga Ulqini dhe fshatrat, duke u shpërngulur në Shkodër e rrethe. Ndër këto familje ishte edhe familja e Hafiz Ali Ulqinakut.

Më pas, duke qenë se familja e tij u shpërngul në Shkodër, e përfundoi shkollën e mesme në medresenë e Bushatllinjve. Shkollimi i tij do të luante një rol tepër të madh jo vetëm për marrjen e dijeve, por edhe në formimin e personalitetit si dhe brumosjen me ndjenjën e dashurisë për atdheun, kombin e gjuhën. Në Shkodër, te Hafiz Ali Ulqinaku patën ndikime mësimet dhe përvojat e personaliteteve të shquara të kohës, si në fushën e fesë, ashtu dhe atë të kulturës e progresit si: Daut Boriçi, Jusuf Tabaku, Sheh Shamia etj. Në vitin 1882 fillon punën si mësues i shkollës fillore të lagjes së vjetër "Dudas" të qytetit të Shkodrës. Në vitin 1884 e transferojnë në Lezhë si mësues dhe si imam. Një ndikim të madh pati dhe jeta e tij në Lezhë, ku gjeti një përkrahje të madhe nga banorët e asaj zone. Personaliteti dhe njohuritë e tij ranë në sy të banorëve të Lezhës, të cilët propozuan për ta graduar me titullin myfti i Lezhës. Autoriteti më i lartë fetar në Stamboll e miratoi këtë kërkesë në vitin 1889. Më 23 prill 1913, Hafiz Ali Ulqinaku ndërroi jetë në Lezhë, por u varros në Shkodër, ku ishte organizuar një ceremoni mbresëlënëse, në të cilën merrnin pjesë të gjithë banorët e Shkodrës. Studiuesit e shumtë e rendisin Hafiz Ali Ulqinakun ndër figurat më të ndritura në fushën e letërsisë, të gjuhësisë, të arsimit dhe të fesë.

Në fushën e letërsisë, njihet sidomos për përkthimet me mjaft vlera. Në vitin 1873 në Ulqin përkthen në shqip Mevludin e shkruar nga poeti me famë Sulejman Çelebi nga Bursa e Turqisë. Ka përkthyer vargjet "Huda Rabbim" të dijetarit dhe filozofit turk Hakki Erzurum. Përktheu dhe përshtati në vargje edhe disa njohuri fetare si një libër besimi të vogël. Të tria këto vepra u shtypën në Stamboll në vitin 1887 në një libër të vetëm. Duke qenë se këto përkthime në shqip ishin bërë në bazë të alfabetit arabo-osman të asaj kohe, në vitin 1936, i biri i tij Hafiz

Seiti, kujdeset për daljen e ribotimit me alfabet shqip të Mevludit nën titullin "Mevludi Sherif". Përveç këtyre veprave të botuara, në dorëshkrim ka hartuar një abetare dhe tre fjalorë të ndryshëm. Fjalori i parë është në vargje, turqisht-shqip. Fjalori i dytë është Fjalor Alfabetik, turqisht-shqip, kurse fjalori i tretë është Fjalor shqip-turqisht, i cili përbëhet prej 4000 fjalësh.

Mevludi në shqip, si kryevepër

Mevludi është vepër e poetit të njohur turk, Sulejman Çelebiut, të cilën e ka përkthyer në gjuhën shqipe Hafiz Ali Ulqinaku. Ky përkthim është përshtatje në gjuhën shqipe, është një poemë që i kushtohet lindjes së Pejgamberit, Muhamedit a.s. Këtë vepër Hafiz Aliu e ka përkthyer në moshën 18 vjeçare, në vitin 1873, kurse është botuar më 1885. Kjo vepër pranohet si kryevepër sepse e ka udhëzuar, frymëzuar shumë brezin jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë kombëtar. Ky Mevlud duhet trajtuar e pasqyruar si segment i veçantë i letërsisë. Ai përmban në brendi teologji e filozofi, mistikë e didaktikë dhe brenda vlerave fetare duken vlerat atdhetare e universale. Sipas studiuesve, Mevludi i Hafiz Ali Ulqinakut mbart vlera të mëdha edukative dhe estetike. Në këtë vepër zë një vend të rëndësishëm përsosmëria morale dhe shpirtërore, që duhet të jetë si shembull për t'u ndjekur nga të gjithë. Mevludi në shqip i Hafiz Ali Ulqinakut u përqafua dhe u këndua brez pas brezi në të gjitha trevat shqiptare. Nga ana tjetër organizimi i festave popullore, ceremoniali i krijuar, ka nxitur miqësinë, bashkimin popullor, mirëkuptimin, vëllazërimin dhe afrimin shpirtëror të njerëzve, ndaj Mevludi përmban edhe vlera të vyera etnografike. Sipas studiuesve të gjuhësisë, Mevludi përcjell vlerat e kontributit të jashtëzakonshëm për ruajtjen e gjuhës shqipe nga ndikimet e gjuhës sllave, sidomos në trevat shqiptare që iu aneksuan Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Njëkohësisht ky Mevlud ka ndikuar dhe në ruajtjen e gjuhës shqipe të shqiptarët që emigruan në vende të ndryshme të botës, në Amerikë dhe Australi.

Vlerësimet

Në të kaluarën, për veprimtarinë e Hafiz Ali Ulqinakut është shkruar pak për mungesë hulumtimesh, gjurmimesh e studimesh, ndërsa më vonë për shkaqe paragykimesh ideologjike e politike. I pari që është marrë me jetën e veprimtarinë e tij është shkrimtari, atdhetari, studiuesi, hulumtuesi, Mit'had Frashëri, (1880 -1949) djali i Abdyl Bej Frashërit, i cili që në vitin 1926 në revistën "Dituria", ka paraqitur fakte interesante e të pabotuara për Hafiz Ali Ulqinakun. Për veprimtarinë e Hafiz Ali Ulqinakut më vonë janë marrë studiues të ndryshëm si dijetarët e mëdhenj e gjuhëtarët Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Faik Luli, Islam Dizdari etj.

Hafiz Ali Ulqinakun e kanë vlerësuar si poet, gjuhëtar, atdhetar e luftëtar, pjesëmarrës aktiv në luftë për mbrojtjen e Ulqinit dhe veprimtar i Lidhjes së Prizrenit. Kulmin e vlerësimeve të veprimtarisë së Hafiz Ali Ulqinakut e simbolizon miratimi, dekorimi me titullin e lartë nderues "Mësues i Popullit" sipas vendimit Nr. 999, më datë 27 dhjetor 1994 nënshkruar nga Presidenti i asaj kohe, z. Sali Berisha, me këtë motivacion: "Klerik dhe intelektual i shquar, studiues i pasionuar, mësues dhe edukator i nderuar i rinisë dhe i masave popullore, hartues e përkthyes i veprave fetare e shkencore".

Zgjëm'i meritueshëm

Mendimi i disave asht shumë i çuditshëm. Këta, tue mos e dijë se ç'dobina i ka sjellë feja njerëzimit, e ngarkojnë atë me fajin e mospërparimit. Mirë po thanijet e tyne nuk vërtetohen me fakte historike, për sa i përket së vërtetës.

Kur kombet Muslimane, në ato kohna, qëndronin në kryetë kulturës, feja ishte burimi i një fuqije që kish për qëllim udhëheqjen e njerëzisë në rrugën e vërtetë të përparimit e të lumtunisë së përgjithëmonëshme. Këtë ka pasë parasysh qytetnimi Islam në të gjithë dukjet e tij. Ai u çue nga mezi i një populli, që pat pushue, praktikisht, nga përparimi njerëzuer.

Islamizmi u çfaq dhe, pa kalue shumë kohë, solli një transformim të plotë. Ishin pikërisht mësimet e besimit të ri, që banë mrekullinë. Arabët ishin, pa përjashtim, pjesa e njerëzimit e lanun ma mbrapa nga çdo pikëpamje, fizike, morale, ekonomike, etj. Ata në sajë të Kuranit, banë përparime të çuditëshme. Ky ndryshim i me njëherëshëm mund të duket si një fenomen i jashtë-zakonshëm, por, po të merret parasysh gjithë ajo çka ai ka sjellë, meriton të drejtën e respektit.

Këto shënime mund të tingëllojnë si akademike, për pa ndonji efekt praktik mbi konditat moderne; mirë po, unë nuk shof no një gjë, praktikisht, të vlefshme në qytetënimin e tashëm, kur t'a heqësh pjesën, që i ka gjirmat ke islamizmi.

Qytetnimi modern ka të mirat dhe të këqijat e veta, dhe mund të them se, kultura e sotçme, në fazat e saj të dëshirueshme, asht një zgjanim që ka burruë nga ajo që islamizmi pat arrijtun.

Pohoj se, konditat e Muslimanëve të sotçëm janë larg nga çka ashtë e dëshërueshme dhe për arsye të qarta. E para asht mos përfillja e urdhërave Kuranore. Kur Muslimanët ishin në kulm të qytetnimit, llukset, lakmitë dhe qejfet personale

filluenë të depërtojnë në veprimet e tyne. Pasurija dhe jeta e rehatshme iu pruni atyne përtacinë e lethargjinë, së cilave iu shtue edhe kriza ekonomike; e kështu i zbriti ata në gjendjen e sotshme. E dyta, mungesa e karakterit, me të cilin një person, si Musliman, duhet të pajoset.

Me kohë do t'a përshkruajmë në faqet e kësaj të përmuajshme se cila asht e meta jonë, dhe vetëm atëhere do të mund t'a kuptojmë e t'a ndjejmë vlerën e karakterit t'onë aqë të dobishëm. Kjo do të mjaftonte t'a shpjegojë të ngelunit ma mbrapa shokëve.

Këtu nuk do të gjeni morale të thata, as fjalë n'ërë, por gjana të vlefshme që mund të vehen lehtë në praktikë, dhe due prej lexuesve që me i pranue ato pa frikë, se pse janë pikërisht ashtu si paraqiten në Kuran dhe në thënijet Profetike.

S'mund t'i përfundoj këto të pakta rreshta për pa u sjellë në mend Muslimanëve e Muslimaneve se veprat bamirëse nuk mund të gjejnë një shpërblim ma të mirë se sa n'atë të shërbimit të fesë së tyne për përkrahjen e letratyrës Islame në Shqipni, si dhe të përhapjes së saj në rininë Muslimane.

Me pak fjalë po e mbyll këtë fletë me shpresë së Muslimanët do t'a flakin idenë e gabueshme dhe se një zgjim i vërtetë e i meritueshëm, në pikëpamje fetare, do t'agojë ndër zemrat dhe mendjet e tyne.

**SHP./ Kultura Islame, Viti I, Tetor, 1939,
nr. 2, fq. 49**



Si të kontrollojmë
Zemërimitin?

Çdo ndjenjë na shërben si një udhëzues për të na lehtësuar punët në jetën e përditshme dhe për të na mbajtur aktivë. Asnjë ndjenjë nuk është e kotë por përjetimi i fortë i disa ndjenjave sjell pasoja të pakëndshme si tek ne ashtu edhe tek njerëzit që na rrethojnë. Ndjenja më kritike për të gjithë ne është zemërimi. Në këtë shkrim ne do të fokusohemi tek shpërthimet e zemërimit, këndvështrimi ynë ndaj tyre dhe tek strategjitë e kontrollimit të zemërimit.

Fillimisht le të analizojmë ndjenjën e zemërimit. Ashtu si çdo ndjenjë tjetër edhe zemërimi është një ndjenjë lehtësisht e përshtatshme me karakterin e njeriut. Kjo ndjenjë transmeton shumë energji, e aktivizon në maksimum individin duke ndikuar edhe në sistemin e tij fiziologjik. Nisur nga ky fakt pasojat janë më të rënda dhe të mprehta. Njeriu ndihet i zemëruar kur nënvlerësohet, kritikohet apo dhunohet dhe me ndihmën e zemërimit arrin t'i thotë ndal aktit të dhunës. Në shumë raste njeriu arrin të kthehet në viktimë për shkak të mosshfaqjes së zemërimit. Në qoftë se arrin t'i thotë jo kritikës, talljes, bullizmit apo dhunës verbale apo fizike me anë të ndjenjës së zemërimit atëherë do të minimizojë mundësinë e përsëritjes së aktit të dhunshëm. Disa marrëdhënie nuk arrijnë të mbartin këtë reagim të zemërimit dhe përfundojnë në divorc.

Ka raste kur situata e cila vë në lëvizje ndjenjën e zemërimit nuk flitet mes dy të rriturve për arsye të shkaqeve të ndryshme dhe personi e pasqyron zemërimin tek njerëz të tjerë. Njeriu fillon të akumulojë brenda vetes ndjenjën e zemërimit për hir të mospërjetimit të krizave, për zhdukjen e keqkuptimeve, për hir të frikës së braktisjes duke u zemëruar më shumë me veten e tij. Tashmë nuk është i zemëruar vetëm me personin përballë por dhe me veten sepse nuk ja jep vetes të drejtën e shprehjes së zemërimit. Personi i mbushur me zemërim e pasqyron zemërimin e tij tek fëmijët, bashkëshorti, vëllezërit, motrat, tek miqtë e tij më të mire. Dhe në fund lind një ndjenjë faji "pse jam kaq i/e zemëruar?". Pastaj fillon të kërkojë përgjigje për pyetjen "si mund të shpëtoj nga shpërthimet e zemërimit?"

Për disa njerëz zemërimi është si dega e vetme ku mund të kapen. Nëse në familjen ku është rritur nuk ka mësuar të shprehë ndjenjat e tij atëherë çdo ndjenjë e re do ta sforcuojë e do të nxisë zemërimin. Edhe nëse ndjehet në ankth apo shqetësphet për diçka këtë do ta shprehë me zemërim sepse nuk ka njohur rrugë tjetër. Ndjenja e fajit ngjitur me ndjenjën e zemërimit përhapet në botën psikologjike të njeriut deh fatkeqësisht njeriu fajtor është më i prirë për të gabuar dhe me kalimin e kohës e gjen veten pjesë të gabimeve të ndryshme.

Çfarë duhet të bëjmë? Jam e sigurt që shumica prej jush jeni përballuar me sugjerime si 'merr frymë thellë', 'numëro deri në 10', 'ndrysho vendin' etj. Por unë në këtë shkrim do t'ju sugjeroj të ndryshoni këndvështrimin tuaj ndaj problemit dhe të kuptoni gjuhën e tij.

Pike së pari ndryshoni mënyrën sesi i afroheni ndjenjës tuaj. Mos harroni, zemërimi nuk është një fatkeqësi nga e cila duhet të shpëtojme. Ndjenjat janë si lajmëtare ose një alarm për zgjidhjen e problemeve të brendshme apo ato të mosmarrëveshjeve në çift. Ashtu siç nuk është zgjidhje fikja e zhurmës së pakëndshme të një alarmi të vendosur në rast të hyrjes së një hajduti ashtu edhe

shtypja e ndjenjave të padëshiruara për hir të shumë të mirave të jetës sonë nuk është zgjidhje e problemit. Për këtë arsye pyetja që duhet drejtuar nuk është 'si të shpëtoj nga zemërimi?' por "Çfarë fshihet pas zemërimit?". Ndoshta në mendjen e shumicës prej jush do t'ju vijnë faktorët nxitës të zemërimit tuaj si për shembull prapësitrat e fëmijës apo ardhja vonë në shtëpi e bashkëshortit. Në të vërtetë zemërimi juaj lidhet më shumë historinë e cila vjen më pas. Ndoshta keni kohë që ndiheni të pavlerësuar, të vetmuar në martesën tuaj, keni përjetuar një zhgënjim në mëngjes dhe jeni munduar ta shtypni brenda vetes. Në këtë moment fëmija juaj është zgjuar plot energji dhe është shumë i lëvizsshëm. Mund ta gjeni veten në një shpërthim zemërimi dhe të thoni 'çfarë kishte për t'u zemëruar kaq shumë?' Padyshim që kjo është një pyetje shumë e drejtë. Po, nuk ka asgjë për t'u zemëruar por në të vërtetë ka shumë arsye, vetëm se fëmija nuk është personi me të cilin duhet të flisni por bashkëshorti juaj. Prandaj përpikuni t'i bëni vetes këta pyetje dhe mbani shënime: 'çfarë ka pas zemërimit tim çfarë nuk shkon në jetën time? Cilat janë mendimet që më përshkojnë më shpesh? Si e ndjej veten në marrëdhënien time me bashkëshortin, familjen dhe miqtë? A mund t'i shpreh hapurazi ndjenjat? A kërkoj ndihmë kur është e nevojshme? A e ndihmoj veten time?

Këta pyetje bëjani vetes me qetësi dhe përpikuni të kuptoni problemin. Pyetjen bëjani vetes kur të jeni vetëm dhe jo në një ambient ku dëgjohen shumë zëra. Përgjigja nuk do të vijë që në pyetjen e pare por përgjigjet do të fillojnë të dalin një nga një ngadalë, ngadalë. Ndoshta mund të zgjasë disa javë, ndoshta disa muaj.


Dua të nënvizoj këtu edhe një here qetësinë, dhembshurinë. Edhe pyetja 'pse nuk arrij të shpëtoj nga ky zemërim?' e bërë nga një person i zemëruar përmban brenda saj zemërim. Zemërimi shuhet vetëm përballë qetësisë e dhembshurisë. Personi i zemëruar kërkon ato njerëz tek të cilët të pasqyrojë mllëfin e tij. Prandaj përpikuni të fokusoheni tek qetësia dhe dhembshuria që keni brenda jush në vend të formulimit të fjalive kritikuese. Zemërimi lind nga ndjenja e fajit, kur të ndiheni fajtor për zemërimin e përjetuar ju në fakt keni krijuar terrenin e përshtatshëm për një krizë tjetër shpërthimi. Në vend të vetëkritikimit ndaloni dhe merrni frymë thellë. Në këtë çast përpikuni të shprehni ndjenjat tuaja përballë një pasqyre, një jasteku apo një muri. Pasi ta bëni këtë të shoqëruar me disa frymëmarrje të thella filloni të mendoni se çfarë mund të bëni më vonë. Nëse ju jeni zemëruar me të padrejtë një person të dashur atëherë përpikuni të kërkonin falje dhe të sqaroni shkaqet që nxitën zemërimin. Puna më e vështirë dhe më e gjatë që do të bëni është të thyeni rrethin vicioz i cili shkakton shpërthimet tuaja. Të zbuloni sjelljet të cilat ju fusin në rrethin vicioz të marrëdhënieve tuaja, të përballeni me ndjenjat më të thella dhe të përdorni strategjitë e zgjidhjes së problemeve janë teknikat më të mira të përballjes dhe zgjidhjes së çështjes së zemërimit. Ndoshta tani mund t'ju duket një proces shumë i vështirë por më besoni që me anë të tij do të rriteni, zhvilloheni dhe të bëni rrugë në udhëtimin tuaj drejt vetes. Zemërimi do të kthehet në një mjet të vyer e të pazëvendësueshëm në rrugëtimin tuaj të maturimit.

Zemra

NUK NDALET KURRË

"Allahu shtrëngon dhe liron, ju tek Ai do të ktheheni". (2: 245)





Zemra është një muskul relativisht i vogël që rreh 100,000 herë në ditë dhe prodhon afërsisht 115,000 Joules energji, e mjaftueshme sa për të zier një filxhan ujë për çaj. Si një lumë që rrjedh, gjaku i deoksigjenuar udhëton nga periferia e trupit tonë në anën e djathtë të zemrës sonë përmes valvulave dhe dhomave derisa të kalojë nëpër mushkëritë tona, ku çdo frymëmarrje që marrim lehtëson oksigjenimin e çdo qelize individuale të gjakut me 4 molekula oksigjeni. Gjaku i oksigjenuar tani, vazhdon të përparojë, duke mos u ndalur kurrë, tani përmes anës së majtë të zemrës, përsëri duke kaluar nëpër valvola dhe dhoma, duke u shtyrë përfundimisht në pjesën tjetër të trupit tonë me ndihmën e barkushes së majtë. Barkusha e majtë është pjesa më e trashë, më e madhe, më e fortë dhe më muskulore e zemrës sepse ka përgjegjësinë e pompimit të gjakut të oksigjenuar përmes valvulës së aortës dhe aortës në pjesën tjetër periferike të trupit tonë. Nëse ky qarkullim i vazhdueshëm ndërpritet ndonjëherë, kjo mund të çojë në rezultate katastrofike.

Ka disa mënyra që kjo rrjedhë mund të ndërpritet, shumë prej të cilave ndodhin para lindjes dhe kërkojnë operacion të menjëhershëm pas lindjes. Defektet kongjenitale të zemrës (CHD) janë disa nga llojet më të zakonshme të defekteve të lindjes, por pasi kujdesi mjekësor dhe trajtimi kanë avancuar shumë, foshnjat

që vuajnë prej tyre zakonisht përfundojnë duke jetuar jetë të gjatë dhe të shëndetshme. Trajtimi nuk kërkohet ndërsa foshnjat janë në barkun e nënës së tyre, sepse qarkullimi i zemrës është i ndryshëm para se fëmija të marrë frymën e parë dhe normalisht ka një përzierje të gjakut të oksigjenuar dhe të deoksigjenuar. CHD mund të jetë i butë, si një vrimë në zemër midis dy dhomave që lejon përzierjen e gjakut të oksigjenuar dhe të deoksigjenuar. Defektet e septumit ventrikular dhe defektet atriale të septumit (vrimat në zemër) janë disa nga format më të zakonshme të CHD. Ndonjëherë këto defekte mund të zgjidhen vetë ose mund të mos realizohen deri më vonë në jetë, ose mund të kërkojnë një riparim "patch" nëse ato janë më të mëdha. Ato shoqërohen me Sindromën Daun, dhe faktorët e rrezikut të nënave duke përfshirë diabetin, mbipeshën dhe pirjen e duhanit. Foramen ovale (një vrimë në zemër që nuk arrin të mbyllet) gjendet në deri në 30% të popullatës së përgjithshme. Zakonisht nuk kërkon trajtim dhe nuk zbulohet nëse komplikacione si një goditje nuk ndodhin më vonë në jetë duke pasur një formë të mpiksjes së gjakut, duke kërkuar që gjaku më pas të kalojë nëpër vrimë dhe më pas të hidhet përmes aortës në tru. Të gjitha foshnjat lindin me duktus arteriosus persistent (duktus arteriosus). Duktusi arteriosus është një enë gjaku fetale që lejon rrjedhjen nga zemra e djathtë në aortë, e domosdoshme kur foshnja është në barkun e nënës, por e papajtueshme për jetën pas lindjes së foshnjës. Brenda ditëve të para të jetës, kjo enë gjaku duhet të mbyllet dhe përfundimisht të shndërrohet në një ligament që ndihmon në lidhjen e arteries pulmonare dhe aortës me njëri-tjetrin. Nëse mbyllja dështon dhe duktusi arterioz mbetet i pambyllur, një zhurmë e vazhdueshme si makineri mund të dëgjohet me stetoskop dhe duhet të fillojë trajtimi me indometacine. E patrajtuar, një PDA mund të rezultojë në cianoze (lëkurë blu / gri) dhe Sindromën Eisenmenger për shkak të uljes së shpërndarjes së oksigjenit.

Përgjegjësia e zemrës nuk është vetëm të sigurojë gjak të oksigjenuar në pjesën tjetër të trupit, por edhe të ushqehet për veten e saj. Muskujt e zemrës konsumojnë 11.6% të konsumit të përgjithshëm të oksigjenit të trupit në mënyrë që të ruajnë aktivitetin e vet kontraktil, duke dalë në vendin e 3-të pas mëlçisë (20.4%) dhe trurit (18.4%). Gjatë tkurrjes ose sistolës, zemra pompon me 120 mm Hg për të siguruar gjak përmes aortës dhe arterieve. Gjatë relaksimit, ose diastolës, zemra zgjerohet dhe lejon që gjaku të mbushet në dhomat e saj dhe gjithashtu të rrjedhë nëpër arteriet koronare. Këto arterie koronare janë arteriet që do të ushqejnë vetë zemrën. Kështu, në mënyrë që të ushqehet vetë zemra duhet të relaksohet dhe për këtë arsye të lejojë arteriet e saj koronare të zgjerohen dhe t'i sigurojnë gjak vetes. Kur zemra tkurret dhe po siguron gjak për pjesën tjetër të organeve, ajo është shumë e shtrënguar për të siguruar gjakun e vetvetes. Meqenëse këto degë janë të vendosura brenda brazdave të zemrës, kur zemra është sistole arteriet janë shumë të shtrënguara për rrjedhjen

e gjakut për shkak të tensionit të shtuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë në lidhje me arteriet që furnizojnë barkushen e majtë pasi ajo është më e madhe dhe më muskulore - mos harroni se këtu do të degëzohet aorta, duke siguruar gjak të oksigjenuar në pjesën tjetër të trupit tonë.

Ky ekuilibër midis tkurrjes dhe zgjerimit mund t'u kujtojë disa lexuesve konceptet e Qabd (tkurrjes) dhe Bast (zgjerimit) në Sufizëm ose Tzimtzum në misticizmin hebre, dhe sesi njëri ushqen vërtet tjetrin duke lejuar kështu rritjen përmes këtij cikli tkurrije dhe relaksimi. Tzimtzum përdoret për të shpjeguar procesin e krijimit, një tkurrije e pafundësisë që ndodh për të lindur një univers të fundëm. Tradita sufiste është një udhëtim personal i përshkruar si "tkurrja dhe hapja janë pazare misterioze që janë bërë pa vullnetin ose qëllimin e udhëtarit. I pari bllokun rrugën e tij ose të saj; e dyta i jep krahët e tij ose të saj për të fluturuar në lartësi të reja ". Ajo që është ndoshta më interesantja është se zemra jonë fizike e kryen këtë tkurrije dhe zgjerim të përkryer për sa kohë që ne kujdesemi për të, ndërsa zemra jonë shpirtërore mund të ketë gabime në këtë ushtrim kritik. Ndoshta, nëse kuptojmë se si të kujdesemi për zemrën tonë fizike, do të gjejmë edhe përgjigjen për ta mbajtur të shëndetshëm zemrën tonë shpirtërore. Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, e thekson këtë lidhje si vijon: "Në të vërtetë, në trup është një copë mishi e cila, nëse është e shëndoshë, i gjithë trupi është i shëndoshë, dhe nëse është i korruptuar, i gjithë trupi është i korruptuar. Me të vërtetë, ajo është zemra. "

Disa mënyra për t'u kujdesur për zemrat tona fizike përfshijnë kryerjen e më shumë aktivitete fizik në jetën tonë të përditshme, të hahet më pak dhe shëndetshëm dhe të kontrollojmë stresin tonë. Ndoshta shëndeti ynë shpirtëror do të përfitonte gjithashtu nga këto dhe aktivitete të ngjashme, duke përfshirë akte të rregullta adhurimi, agjërim, kontroll të durimit tonë dhe sjellje të mirë me të tjerët. Kur nuk kujdesemi për zemrën tonë fizike, ajo fillon të dështojë pasi oksigjeni nuk shpërndahet mirë në zemrën tonë dhe rrymat elektrike nuk mund të udhëtojnë më në mënyrë efektive, duke rezultuar kështu në një sulm në zemër.

Sëmundja e arterieve koronare është shkaku kryesor i vdekjeve në të gjithë botën, dhe veçanërisht në vendet e zhvilluara. Sulmi më vdekjeprurës i zemrës ndodh nëse ka një bllokim të arteries koronare në pjesën e përparme të majtë, e cila është arsyeja pse ajo quhet tragjikisht "krijues i vejushave". Duke filluar nga adoleshenca, arteriet fillojnë të grumbullojnë vija yndyrore dhe të përparojnë në një pllakë ateriosklerotike. Kjo pllakë mund të çojë në disa komplikime katastrofike, si më poshtë:

- një ngushtim ose bllokim i plotë i një arterie, duke dëmtuar rrjedhën e gjakut dhe duke e lënë zemrën të etur për oksigjen

- një goditje në tru për shkak të një mpiksje gjaku të shkaktuar nga lëvizja e ngadalesuar, prishja dhe rrjedhja në tru

- një dobësim i murit të enës që çon në një aneurizëm, ena çahet

Për disa pacientë, një sulm në zemër perben një

thirrje zgjimi në mënyrë që të bëjmë shumë ndryshime të nevojshme në stilin e jetës që janë të nevojshme për të jetuar një jetë të gjatë dhe të shëndetshme. Sidoqoftë, 20% e pacientëve do të përfetojnë një sulm të dytë në zemër. Ndërsa zemra dobësohet dhe dobësohet, ajo përfundimisht mund të zhvillojë sindromën kardio-renale, një ndërlikim që rezulton nga zemra që nuk mund të pompojë në mënyrë efektive duke rezultuar në atë që të mbështetet në zemër dhe në anën e djathtë të trupit. Kjo rritje e vëllimit në trup përkeqësohet më tej nga veshkat, të cilat vazhdojnë të mbajnë lëngjet dhe kështu bëjnë që trupi të mbingarkohet. Kjo çon në edemë, ose ënjtje, në këmbë që përfundimisht mund të përparojnë në mushkëri dhe të shkaktojnë dështimin kongjektiv të zemrës. Ndërsa veshkat përpiqen të përmirësojnë faktin se zemra nuk po pompon në mënyrë efektive, ato në fund të fundit përkeqësojnë situatën duke çuar në fazën përfundimtare të sëmundjes renale dhe fazës D të dështimit të zemrës.

Sigurisht, ashtu si me pothuajse të gjitha kushtet mjekësore, këto rezultate fatale mund të parandalohen shumë më herët me ndryshime të stilit të jetës, madje edhe para futjes së ndërhyrjes mjekësore me ilaçe me recetë ose procedura të tjera. Këto modifikime të stilit të jetesës përfshijnë ushtrime të moderuara aerobike të paktën 3 herë në javë, një dietë të pasur me perime dhe me pak yndyrna, sheqerna dhe karbohidrate, ndalimin e pirjes së duhanit dhe alkoolit dhe uljen e peshës (e cila do të vinte si rezultat i këtyre modifikimeve). Është gjithashtu e rëndësishme për pacientët që tashmë kanë hipertension, diabet dhe hiperlipidemi duhet t'i mbajnë ato të menaxhuara mirë dhe të kontrollohura.

Ndoshta në mënyrë të ngjashme, disa ndryshime të thjeshta jetese, të tilla si lënia mënjanë disa minuta çdo ditë për të reflektuar, mund të jenë sekretet për të mbajtur të shëndetshme zemrën tonë shpirtërore. Zemra jonë duhet të mbetet e shëndetshme për të mbajtur pjesën tjetër të trupit tonë të shëndetshëm. Duke marrë parasysh marrëdhënien e ngushtë midis zemrës sonë fizike dhe shpirtërore, zemra jonë shpirtërore duhet të mbahet e shëndetshme për të mbajtur të shëndetshëm pjesën tjetër të trupit tonë shpirtëror. Individët e shëndetshëm shpirtërisht do të forcojnë më tej shëndetin e komunitetit tonë, sepse Profeti Muhamed, paqja qoftë mbi të, thotë: "Besimtarët në mirësinë, dhembshurinë dhe simpatinë e tyre të ndërsjellë janë njësoj si një trup i vetëm. Kur njëra prej gjymtyrëve vuan, i gjithë trupi i përgjigjet me zgjim dhe ethe. "

"Ndërsa e gjithë ekzistenca është në zotërimin e Tij dhe në dispozicionin e Tij të lirë, është Ai që drejton dhe disponon të gjitha gjërat, nga qiejt në zemrën e njeriut ... Kur të dojë Zoti, Ai e tkurr një zemër kaq fort për atë që vetëm Ai mund të sigurojë që vetëm Ai mund ta kënaqë atë. Në të kundërt, Ai e zgjeron dhe e gëzon atë në një masë të tillë që nuk ka nevojë për asgjë. Tkurrja shkaktohet nga Madhështia e Zotit, zgjerimi është shkaktuar nga Hiri i Tij. (Fethullah Gylen, Kodrat e smeralda të Zemrës). "

Përktheu: Erion Sukaj



Shqetësimi i luanit

Një ditë, mbreti luan, thirri tigrin, të cilin e kishte caktuar në postin e ministrit. I tha: – O tigër, nuk jam fare i qetë. Dua të di se, kush prej popullit tim më do me të vërtetë dhe kush nuk më do. Prandaj, kërkoj prej teje që të përhapësh lajmin e vdekjes sime. Ndërsa unë do të shëtis fshehtas nëpër pyll, për të mësuar mendimet e banorëve në lidhje me mua.

Me të marrë urdhrin, tigri doli në pyll dhe përhap lajmin e vdekjes së luanit. Kur e dëgjuan këtë lajm, kafshët nuk u besuan veshëve. Menjëherë filluan të pyesin se ç'kishte ndodhur. Lajmin e besuan menjëherë, sepse atë e kishte sjellë tigri, vetë ministri i luanit.

Luani i maskuar filloi të shëtiste në pyll. Teksa ecte, dëgjoi dhelprën që thoshte: “O sa mirë! Tani që nuk ka më mbret, mund t’ia filloj përsëri nga dinakëritë e mia. Tani, askujt nuk i jap llogari. Sa mirë që vdiq luani!”

Luani u largua dhe vazhdoi të shëtiste. Kësaj here dëgjoi ujkun dhe çakallin që flisnin ndërmjet tyre: “Që kur vdiq luani, kemi rënë rehat! S’kemi pse të frikësohemi më! Sa e vështirë paska qenë të bësh sikur e do dikë që nuk e do...”

Kështu, pak nga pak, luani filloi të shihte fytyrën e vërtetë të banorëve të pyllit. U mërziq jashtë mase, sepse mendonte se nuk i meritonte të gjitha

këto. Ato që dëgjoi atë ditë, nuk i pëlqyen.

Erdhi e nesërmja. Ai vazhdoi shëtitjen në pyll. Dëgjoi tigrin, ministrin i tij, teksa i thoshte ariut: – Ari, vëlla, mbaje gjuhën gjatë këtyre ditëve. Mbreti ynë, në të vërtetë nuk ka vdekur, por bën gjoja... Prandaj, mos fol, asnjë fjalë të keqe për të. Kur i dëgjoi këto fjalë, luani nuk e deshi më veten. Ndhmësi i tij besnik, tigri, sapo i kishte nxjerrë të fshehtë.

– Nëse ministri im bën kështu, po të tjerët çfarë bëjnë vallë? – foli ngadalë-ngadalë e me zë të ulët luani. Mua nuk më do njeri në këtë pyll.

Mori rrugën drejt pallati të tij. Diku, pranë një guve, dëgjoi një lepurush me lot në sy, që i tha: – Mbreti im! Pa ty, pylli është bosh. Kafshët kanë mbetur pa udhëheqës dhe i forti ka filluar të shtypë të dobëtin.

Luani e vështroi mirë e mirë dhe iu përgjigj: – Miku im besnik! Unë nuk kam vdekur. Mos ki frikë, këtej e tutje do të jetoj për ty dhe për ata si ti...

Të nesërmen, puna e parë që bëri, ishte dëbimi i tigrin nga puna. Në vend të tij vuri lepurushin, si ministër. Pas asaj ndodhie, luani e kuptoi se jo çdokush që të rri pranë është miku yt. Miqtë e vërtetë janë ata, që të duan pa interes.



Jeta e Sahabëve

www.kmsh.al/botime

Ky botim në dy vëllime, vjen nga Komuniteti Mysliman jo vetëm si një përmbledhje fragmentesh nga jeta shembullore e sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), por është edhe një histori e mirëfilltë e Islamit dhe pasqyrim i hollësishëm i jetës së Profetit tonë, pasi këtui, jeta e sahabëve, si dhe shumë nga ngjarjet që rrëfehen si të transmetuara nga burimet më të besueshme të Islamit, janë të paraqitura sipas një kategorizimi dhe prezantimi në kapituj të hartuar sipas kriterit tematik. Pra, dobia e prurjes së këtij libri në gjuhën shqipe, është se ai përmbush tri qëllime:

- 1 Një njohje më nga afër me përmasën e të qenët sahab i të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilën e garanton pasuria dhe larmia e historive të treguara në të.
- 2 Sjell në gjuhën shqipe një histori të Islamit në fillimet e tij, të parë si mënyrë jetese e pandarë nga jeta e përditshme.
- 3 Një dimension të posaçëm të përditshmërisë së jetës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilin një biografi e ka shumë të vështirë që ta paraqesë në tërësinë e tij, për shkak të pasurisë së informacionit.

BOTIM I RI

